



GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË
.....
VITI IV / NR. 58 / 10 GUSHT 2009

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Editon: Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës botohet në mbështetje të *Ligjit për Gazetën Zyrtare nr. 2004/47*; si dhe *Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/25 për shpalljen e Ligjit për Gazetën Zyrtare*.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës boton tekstet zyrtare dhe përfundimtare të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallura nga Presidenti i Republikës së Kosovës; rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, rregullativat dhe aktet e tjera normative të Qeverisë dhe ministrive; marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar etj.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, botohet në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, angleze, serbe, turke dhe atë boshnjake.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës administrohet nga Zyra për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Mbikëqyrja editoriale:

Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit, **FITIM KRASNIQI**

Drejtor i Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës:

Naser Canolli

Redaktor përgjegjës:

Mentor Hoxha

Redaksia

Hysen Bajramaj

Shqipe Fazliu - Gashi

Besart Graiçevci

Adresa dhe korrespondencat:

Ndërtesa e re e Qeverisë,

Prishtinë

www.gazetazyrtare.com

038-201 14039

www.ks-gov.net/gazetazyrtare

NË RAST MOSPËRPTHJE NDËRMJET VERSIONEVE GJUHËSORE TË AKTEVE
JURIDIKE TË BOTUARA DHE TË PUBLIKUARA NË GAZETËN ZYRTARE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËRPARËSI DO TË KENË GJUHËT ZYRTARE NË
PËRPTHJE ME KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

PËRMBAJTJA

<i>LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË.....</i>	<i>1</i>
<i>LIGJI PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE.....</i>	<i>8</i>
<i>LIGJI PËR LIZINGUN.....</i>	<i>12</i>
<i>LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR.....</i>	<i>21</i>
<i>LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....</i>	<i>24</i>
<i>LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/ 17 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 02/ L-99.....</i>	<i>30</i>

Ligji Nr. 03/L-138**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË**Neni 1**

Neni 1, paragrafi 1 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si vijon:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i sektorit të Naftës dhe Derivateve të Naftës që ka të bëjë me tregtimin, licencimin dhe monitorimin e rregullt të tregut me Naftë dhe Derivate të Naftës, përmes nxitjes së konkurrencës dhe eliminimit të praktikave të pa lejuara tregtare”.

Neni 2

Në tërë tekstin e Ligjit nr. 2004/5 dhe të Ligjit nr. 02/L-89, për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë, përkufizimi dhe fjala **“transporti”** (nëse është në kontekst të transportimit), fshihet.

Neni 3

1. Në nenin 2, përkufizimet e termave të ligjit plotësohen dhe ndryshohen si vijon:

“Derivatet e naftës” nënkupton produktet e përfituara

nga nafta si: benzinë, kerozin karburant dizel, auto dizel, vajguri, vaj lubrifikues, vaj motori, naftë, kundërngrirërës, glicerinë për frerë dhe vajra të rënda.

Zëvendësohet përkufizimi **“Këshill”** me përkufizimin **“Zyra e Licencimit”** kjo vlen për tërë tekstin e ligjit.

“Rezervat emergjente të derivateve të naftës” nënkupton sasi e derivateve të naftës të dedikuara për përdorim në raste të fatkeqësive të mëdha natyrore dhe të gjendjes së jashtëzakonshme.

Në përkufizimin **“Shërbim doganor”** nistoret: **“UNMIK”** zëvendësohen me fjalën: **“Kosovës”**.

“Licencë” – nënkupton dokumentin me shkrim, të lëshuar nga Zyra e Licencimit, të paraparë me këtë ligj, që personit të caktuar ia njeh të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në sektorin e naftës dhe të derivateve të saj në Kosovë.

Përkufizimi **“Shënim”** ndryshohet dhe bëhet **“Të dhënat bazë”** (dhe kjo vlen për tërë tekstin e ligjit). Teksti i këtij përkufizimi riformulohet si vijon:

“Të dhënat bazë” nënkuptohen shënime të regjistruara nga Zyra e Licencimit lidhur me emrin, adresën, numrin e identifikimit të tatimpaguesit dhe nëse ato zbatohen, numrin e certifikatës së regjistrimit të aplikuesit të evidencuar në Zyrën e Licencimit.

2. Në nenin 2 të ligjit shtohen katër përkufizime të reja me tekstin si vijon:

“Përpunimi” nënkupton procesin e përpunimit të lëndëve të para nga nafta dhe derivatet e naftës për përfitimin e produkteve finale.

“Komisioni” nënkupton Komisionin për Ankesa, që ka për detyrë t'i shqyrtojë ankesat kundër vendimeve të Zyrës së Licencimit.

“Certifikatë Doganore” nënkupton certifikatën e lëshuar nga Dogana e Kosovës për ushtrimin e veprimtarisë import-eksport.

“Organ i autorizuar” nënkupton organin për vlerësim të konformitetit që mund të jetë: organ inspektimi, i akredituar sipas standardit ISO /IEC 17020, testues i akredituar si-

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

pas standardit ISO /IEC 17025 ose certifikues i akredituar sipas standardit ISO /IEC 4011.

Neni 4

Ndryshohet titulli i nenit 3 të ligjit “**KRIJIMI DHE FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT**” dhe tërë teksti i nenit si vijon:

Neni 3**THEMELIMI DHE FUSHËVEPRIMI I ZYRËS SË LICENCIMIT**

- 3.1 Zyra e Licencimit themelohet në kuadër të MTI-së me shërbyes civilë, që i përgjigjet ministrit.
- 3.2 Veprimtaria themelore e Zyrës së Licencimit është t'i japë, t'i vazhdojë, t'i pezullojë, t'i ndryshojë ose t'i revokojë licencat në pajtim me këtë ligj.
- 3.3 Licencat i nënshkruan ministri.
- 3.4 Kundër vendimit të Zyrës së Licencimit, pala e pakënaqur mund të ankohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 3.5 Organizimi i Zyrës, numri dhe përgatitja profesionale e shërbyesve civilë, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Licencimit dhe procedurat e licencimit, rregullohen me akt nënligjor të ministrisë.
- 3.6 Anëtarit të Këshillit, (sipas nenit 3 të ligjit në fuqi), me hyrjen në fuqi të këtij ligji i vazhdohet mandati i mbetur, në cilësi të anëtarit të Zyrës së Licencimit.

Neni 5

1. Në paragrafin “4.1” të ligjit, pas fjalës “deponim” shtohet fjala “import” ndërsa pjesa tjetër e tekstit mbetet e pandryshuar.
2. Në paragrafin 4.2 të ligjit, fshihet teksti ekzistues dhe zëvendësohet me tekstin si vijon:
 - 4.2. Zyra e Licencimit do të shqyrtojë dhe marrë vendim për pajisjen me licencë për veprimtari në sektorin e tregtimit dhe përpunimit të naftës dhe derivateve të naftës.

3. Në paragrafin 4.2 të ligjit fshihen pikat: a,b,c,d,e dhe f.” dhe zëvendësohen me riformulim dhe rinumërim të ri si vijon:

- a) Licencat do të jepen për import, deponim, shitje me shumicë, shitje me pakicë, dhe përpunim.
- b) Ministri, me akt nënligjor, do të përcaktojë produktet e naftës dhe derivateve të naftës qarkullimi i të cilave i nënshtrohet licencimit, llojet e licencave dhe kushtet për marrjen e tyre.

4. Në nenin “4” të ligjit pas paragrafit “4.2” shtohet një paragraf i ri i cili bëhet “4.3” me tekstin si vijon:

- 4.3. Procedurat për licencimin e kompanive që merren me përpunimin e lëndëve të para të naftës dhe derivateve të saj, rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga Ministri.

5. Në nenin “4” të ligjit paragrafi “4.4” fshihet në tërësi.

6. Paragrafi “4.3” i ligjit bëhet “4.4”.

7. Paragrafi “4.6” i ligjit fshihet dhe riformulohet me tekstin si vijon:

- 4.6. “Personat të cilët ushtrojnë veprimtari në servisim të automjeteve mund të shfrytëzojnë, për nevoja vetanake, vajra lubrifikues, vajra motorik, vaj kundërngrirës dhe vaj frerësh, pa u licencuar”.

8. Pas paragrafit “4.6” të ligjit shtohen 3 paragrafë me tekstin dhe me rinumërim të ri si vijon:

- 4.7 Ministri ka të drejtë që në rast se vlerëson se nuk janë zbatuar procedurat ligjore, lidhur me marrjen e çdo vendimi të Zyrës së Licencimit, mund të pezullojë atë vendim dhe së bashku me gjithë lëndën t'ia kthejë Zyrës së Licencimit, në rishqyrtim.
- 4.8 Në rastet kur edhe pas rishqyrtimit, Zyra e Licencimit, nuk mënjanon parregullsitë, Ministri përcjell lëndën te Komisioni i ankesave për vendosje.”
- 4.9 Deri në vendosjen nga Komision i ankesave, vendimi i Zyrës së Licencimit, konsiderohet i

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

pezulluar dhe nuk prodhon efekte juridike.”

aplikuesi Informata plotësuese për verifikimin e dëshmive të parashtruara.

9. Paragrafët “4.7” dhe “4.8 “ të ligjit bëhen dhe rinumërohen si vijon: 4.10 dhe 4.11.

Neni 7

Neni 6

“Neni 6” i ligjit fshihet në tërësi.

1. Në nenin “5”, të ligjit i paragrafi “5.2”, fshihet në tërësi teksti ekzistues dhe zëvendësohet me tekstin si vijon:

Neni 8

5.2. Lartësia e taksave për secilin lloj të licencave dhe përtëritjen e tyre do të përcaktohet me akt nënligjor nga Ministri.

1. “Neni 7” të ligjit rinumërohet dhe bëhet “neni 6” ndërsa paragrafi “7.1” riformulohet dhe rinumërohet 6.1 me tekstin si vijon:

2. Paragrafi 5.6 i ligjit pika b) fshihet.

- 6.1 Së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të afatit të licencës ekzistuese, subjekti është i obliguar të paraqesë kërkesë për përtëritje të licencës.

3. Në paragrafin 5.6 të ligjit pika “c)” riformulohet:

c) Dëshminë e vërtetuar, se tërësisht ka përm-bushur obligimet ndaj institucioneve shtetërore - tatimet, taksat, dhe detyrime të tjera.

Pas paragrafit 6.1. shtohet paragrafi i ri 6.2 me tekstin si vijon:

4. Në paragrafin 5.6. të ligjit, pika “e)” riformulohet:

e) Dëshmi se drejtori apo menaxheri kryesor nuk është dënua për vepër penale heqje lirie 6 muaj apo më tepër.

- 6.2. Në rast se Zyra e Licencimit nuk jep vendim brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës për përtëritje të licencës, subjekti vazhdon ta ushtrojë veprimtarinë deri sa të marrë përgjigje.

Paragrafi 7.2 tashmë i rinumëruar si 6.2. bëhet paragrafi 6.3 dhe mbetet teksti i njëjtë si në ligj.

5. Në paragrafin 5.6 të ligjit, pika “h)” riformulohet si vijon:

h) Polisa e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta në lartësi prej 1 €/litër të kapaciteteve të rezervoarëve të naftës dhe derivateve të naftës për shitje me pakicë apo deponim.

Neni 9

6. Në paragrafin 5.7 të ligjit, teksti ekzistues fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si vijon:

1. Neni 8 i ligjit rinumërohen si neni “7”.
2. Paragrafi “8.2” i ligjit, rinumërohet si neni “7.2” dhe riformulohet si vijon:

5.7 Në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës, Zyra e Licencimit, merr vendim për pajisje me licencë në përputhje me kushtet e përcaktuara.”

- 7.2. Zyra e Licencimit është e autorizuar ta pezullojë ose ta revokojë licencën nëse: (teksti i nënpikave : a, b, c, d mbetet si në ligj).

Neni 10

7. Paragrafi 5.8 të ligjit i cili është në fuqi riformulohet si vijon:

5.8 Si pjesë e procesit të licencimit, Zyrës së Licencimit, është e autorizuar të kërkojë nga

“Neni 9” i ligjit rinumërohet si neni “8”.

Ndryshohet titulli i nenit 9 “RISHQYRTIMI DHE ANKESA NDAJ VENDIMEVE TË KËSHILIT” me gjithë tekstin e nenit si vijon:

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË**Neni 8****THEMELIMI I KOMISIONIT PËR ANKESA**

1. Ministri e emëron një komision pesë (5) anëtarësh për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të Zyrës së Licencimit.
2. Komisionin e përbëjnë: një përfaqësues i MTI-së, një i MEF-it, një i MEM-it, një i biznesit të sektorit të naftës dhe një i Komisionit Kosovar të Konkurrencës.
3. Mandati i anëtarëve të Komisionit është tre vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtarët e Komisionit takohen sipas nevojës dhe për punën e tyre nuk marrin pagë të rregullt, por marrin mëditje në lartësi të mëditjes përkatëse në Kosovë.
5. Vendimet e Komisionit i nënshkruan kryetari i Komisionit.
6. Komisioni i Ankesave për punën e vet i përgjigjet ministrit të MTI-së.
7. Punët përkatëse administrative të Komisionit i kryen shërbimi i administratës së Ministrisë.
8. Kundër vendimit të Komisionit, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën administrative.
9. Komisioni gjatë shqyrtimit të ankesave, zbaton procedurat sipas Ligjit për procedurën administrative.

Neni 11

“Neni 10” i ligjit rinumërohet si neni “9”.

Ndryshohet titulli i nenit 10 “HARMONIZIMI ME BASHKËSINË EVROPIANE (BE)” me gjithë tekstin e nenit si vijon:

Neni 9**STANDARDET E NAFTËS DHE DERIVATEVE TË NAFTËS**

- 9.1 Ministria do të shqyrtojë dhe miratojë, me akt nënligjor, standardet për cilësi të naftës dhe derivate të naftës, duke marrë për bazë stan-

dardet e harmonizuara të BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

- 9.2 Gjatë përcaktimit të standardeve, sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria duhet të ketë çdo herë parasysh që aplikimi i tyre të mos shkaktojë ç'rregullime në furnizimin e tregut me naftë dhe derivate të naftës, apo favorizim të një prodhuesi apo vendi.
- 9.3. Ministria do të shqyrtojë në vazhdimësi standardet duke marrë për bazë përputhshmërinë e tyre me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Neni 12

“Neni 11” i ligjit rinumërohet si neni “10”.

Ndryshohet titulli i nenit 11 “REZERVAT EMERGJENTE DHE OPERATIVE”.

Neni 10**REZERVAT EMERGJENTE DHE MASAT NDËRHYRËSE**

1. Ndryshohet paragrafi 11.1. i ligjit i rinumëruar 10.1. si vijon:
 - 10.1 Ministria mbikëqyrë dhe inspekton cilësinë e naftës dhe derivate të naftës në treg.
2. Teksti i paragrafit 11.2. mbetet i njëjtë si në ligj por rinumërohet 10.2.
3. Ndryshohet paragrafi 11.3. i ligjit i rinumëruar 10.3. si vijon:
 - 10.3 Të gjitha deponitë dhe pikat shitëse të naftës dhe derivateve të naftës janë të obliguara që të mbajnë në çdo kohë në stoqe së paku 5% të kapaciteteve të tyre deponuese, për qëllime të rezervave emergjente. Në kushte të çrregullimeve në treg, Ministri me akt nënligjor mund të caktojë nivel më të lartë të rezervave emergjente.”

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

4. Paragrafët “11.4 , 11.5 dhe 11.7” fshihen, ndërsa paragrafi “11,6” i ligjit rinumërohet si paragrafi “10.4 dhe mbetet teksti i njëjtë si në ligj.

Neni 15

Neni “13” i ligjit fshihet në tërësi .

Neni 13**Neni16**

Pas nenit “11” të ligjit të rinumëruar si neni “10” shtohet një nen i ri 11, si vijon:

Neni 11

11.1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në propozim të Ministrit të MTI-së, mund të ndërhyjë në rastet e çrregullimit në tregun e brensdhëm, dhe atë:”

- a) kur ka mungesë të papritur dhe të vazhdueshme të naftës dhe derivateve të saj;
- b) fatkeqësive të mëdha natyrore, apo;
- c) lëvizjeve të mëdha të çmimit të naftës dhe derivateve të saj në tregun botëror dhe mospërshtatjen e çmimeve vendore me lëvizje të tilla.

11.2 Qeveria mundet, më qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve, eliminimit të çrregullimeve në treg apo nga arsyet e tjera në interes shtetëtor, të përcaktojë çmimet shitëse maksimale (minimale) me shumicë dhe pakicë, të përcaktoje marzhat tregtare maksimale për shitje me shumicë dhe pakicë, si dhe të ndër-marrë masa të tjera në përputhje me ligj.

11.3 Në raste të ndërhyrjes, çmimi i naftës dhe derivateve të saj, duhet të përcaktohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

11.4 Aplikimi i masave të këtilla mund të bëhet vetëm për periudhë të caktuar kohore por jo më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë pa ndërprerje.

Neni 14

1. Neni “12”, paragrafi “12.3” i ligjit riformulohet si vijon:

12.3. Ndalohet përdorimi i mjeteve matëse të pakalibruara gjatë shitjes së naftës dhe derivateve të naftës dhe shitja me shumicë e derivateve të naftës personave të pa licencuar.

1. “Neni 14” i ligjit rinumërohet si neni “13”.

2. Ndryshohet paragrafi 14.1. i ligjit i rinumëruar 13.1. si vijon:

13.1 Ministria ka për detyrë që në afat prej gjashtë (6) muajsh të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

3. Ndryshohet paragrafi 14.3. i ligjit i rinumëruar 13.3. si vijon:

13.3 Inspektimin e bën inspeksioni kompetent dhe organi i autorizuar nga Ministri.

4. Ndryshohet paragrafi 14.4. i ligjit i rinumëruar 13.4. si vijon:

13.4 Inspektorati në pajtim me Ligjin për inspektimin e tregut, në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ngrit procedurën në gjykatë dhe në organet e tjera kompetente.

5. Ndryshohet paragrafi 14.5. i ligjit i rinumëruar 13.5. si vijon:

13.5. Inspektorati gjithashtu ka të drejtë ta fillojë procedurën e pezullimit të licencës në Zyrën e Licencimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të paragrafëve: 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të nenit 17 të këtij ligji.

6. Paragrafi “14.6” i ligjit rinumërohet “13.5” dhe mbetet teksti i njëjtë si në ligj.

Neni 17

Neni “15” i ligjit rinumërohet si neni “14” dhe riformulohet si vijon:

14.1. Për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) Euro deri në tridhjetëmijë (30,000)

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

- Euro, ndëshkohet personi juridik i cili zhvillon veprimtarinë e shitjes me pakicë në sektorin e naftës pa licencë paraprake, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumën prej njëmijë (1,000) Euro deri në tremijë (3,000) Euro.
- 14.2. Për kundërvajtje me gjobë prej pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, deri në njëqind e pesëdhjetëmijë (150.000) Euro, ndëshkohet personi i cili zhvillon veprimtarinë e shitjes me shumicë në sektorin e naftës pa licencë paraprake, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumën prej pesëmijë (5,000) Euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000) Euro.
- 14.3. Për kundërvajtje me gjobë prej tridhjetëmijë (30.000) Euro deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, ndëshkohet personi që e ka licencën, në qoftë se bën mashtrim lidhur me prejardhjen e naftës dhe derivateve të saj, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf, gjobitet në shumën prej tremijë (3,000) Euro deri në pesëmijë (5,000) Euro.
- 14.4. Për kundërvajtje me gjobë prej tridhjetëmijë (30,000) Euro deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse përdorë emërtim tjetër të produktit të naftës dhe derivateve të saj, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf, gjobitet në shumën prej tremijë (3,000) Euro deri në pesëmijë (5,000) Euro.
- 14.5. Për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) Euro deri në tridhjetëmijë (30,000) Euro ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim lidhur me emrin dhe identitetin e shitësit, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumën prej njëmijë (1,000) Euro deri në tremijë (3,000) Euro.
- 14.6. Për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) Euro deri në tridhjetëmijë (30,000) Euro ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim me sasinë e naftës dhe derivateve të saj, në shitjen me pakicë, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumën prej njëmijë (1,000) Euro deri në tremijë (3,000) Euro.
- 14.7. Për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) deri në tridhjetëmijë (30,000) Euro, ndëshkohet personi që e ka licencën, nëse bën mashtrim me cilësinë e naftës dhe derivateve të saj në shitjen me pakicë, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf, gjobitet në shumën prej njëmijë (1,000) Euro deri në tremijë (3,000) Euro.
- 14.8. Për kundërvajtje me gjobë prej pesëdhjetëmijë (50,000) Euro deri në njëqind e pesëdhjetëmijë (150.000) Euro, ndëshkohet personi që ka licencën, nëse bën mashtrim me cilësinë e naftës dhe derivateve të saj në shitjen me shumicë, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf, gjobitet në shumën prej pesëmijë (5,000) Euro deri në pesëmbëdhjetëmijë (15,000) Euro.
- 14.9. Për kundërvajtje me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, ndëshkohet personi që ka licencën, nëse përdorë njësi dhe stabilimente matëse të pakalibruara, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumë prej njëmijë (1,000) Euro deri në pesëmijë (5,000) Euro.
- 14.10. Për kundërvajtje me gjobë prej tridhjetëmijë (30,000) Euro deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, ndëshkohet personi që ka licencën, nëse në forma të palejueshme ndotë ambientin ku vepron, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf gjobitet në shumën prej tremijë (3,000) Euro deri në pesëmijë (5,000) Euro.
- 14.11. Për kundërvajtje me gjobë në lartësi prej 30% të vlerës së mallit të shitur, dënohet personi i licencuar i cili i shet mall kompanisë së palicencuar nga sektori i naftës, me të njëjtën gjobë dënohet edhe kompania e palicencuar, kurse personi përgjegjës nga ky paragraf dënohet me gjobë prej njëmijë (1,000) Euro deri pesëmijë (5,000) Euro.

Neni 18

1. Pas nenit të rinumëruar "14" të ligjit shtohen edhe tri (3) nene të reja si vijon:

Neni 15

- 15.1. Në rast të përsëritjes së shkeljes, shumata e gjobës rritet për 50%. Nëse ndodh edhe rasti i tretë i shkeljes, atëherë gjoba dyfishohet.
- 15.2. Dënimet me gjobë, të përcaktuara me këtë ligj, nuk përjashtojnë përgjegjësinë e paraprakë me ligje të veçanta.

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR.2004/5 PËR TREGTINË ME NAFTË DHE DERIVATE TË NAFTËS NË KOSOVË

- 15.3. Përveç dënimit me gjobë, personit juridik të cilit më parë i janë shqiptuar së paku 3 gjoba brenda një viti, i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në sektorin e naftës në kohëzgjatje prej jo më pak se tre muaj dhe jo më gjatë se dy vjet, ndërsa personit përgjegjës, i shqiptohet masa mbrojtëse e ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë në punë të njëjta, në kohëzgjatje prej së paku një viti dhe jo më gjatë se tri vite.
- 15.4. Zyra e Licencimit në bazë të propozimit të inspektoratit ia pezullon licencën gjerë në ditën e zbatimit të gjobës së shqiptuar subjektit të caktuar, që brenda afatit të caktuar nuk e zbaton vendimin e gjykatës kompetente.

Neni 16

Me qëllim të zbatimit të drejt të këtij ligji Dogana e Kosovës nuk do të lëshojë në qarkullim të lirë mallin për të cilin kërkohet licenca sipas dispozitave të këtij ligji apo akt tjetër me shkrim nga Ministri i TI-së.

Neni 17

Mjetet e arkëtuara nga shqiptimi i gjobave derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 19

Ligji për plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës, hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-138
25 qershor 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-018-2009, datë
17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.

LIGJI PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE

Ligji Nr. 03/L-137

PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË
LIGJORE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR DEPARTAMENTIN E
MJEKËSISË LIGJORE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1. Ky ligj themelon Departamentin për Mjekësi Ligjore si organ publik kompetent, përgjegjës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore, hetime mjekësore mbi vdekjen përfshirë edhe ekshumimin (zhvarrosjen) e mbetjeve mortore të shkaktuar si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe kthimin e mbetjeve mortore tek familjet e tyre.
2. Me këtë ligj përcaktohet struktura organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Neni 2
Përkufizimet

1. Për qëllimet e këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“**Mjekësia Ligjore**” është degë e mjekësisë që zbaton njohuritë nga fusha e mjekësisë për çështjet dhe procedurat ligjore.

Mjekësia Ligjore përfshinë por nuk kufizohet në diciplinat si: mjekësia ligjore klinike, toksikologjia, histopatologjia, patologjia mjeko-ligjore, antropologjia mjeko-ligjore, arkeologjia mjeko-ligjore dhe odontologjia mjekoligjore.

“**Patologjia mjeko-ligjore**” është degë e mjekësisë që merret me përcaktimin e shkakut dhe raportimin e fakteve që lidhen me mënyrën e vdekjes së personit.

“**Autopsia**” është procedurë mjekësore që konsiston në ekzaminimin e tërësishëm të trupit apo mbetjeve mortore për të përcaktuar shkakun dhe kohën e vdekjes dhe të bëjë vlerësimin e ndonjë lëndimi që mund të jetë prezent, apo të përcaktoj natyrën e sëmundjes që ka shkaktuar vdekjen, si dhe studion patologjinë e sëmundjes.

“**Ekzaminimet klinike mjekoligjore**” janë procedurë që konsiston në ekzaminimin e individëve të gjallë për të diagnostifikuar sëmundjen, studimin e lëndimeve, ose gjendjes shëndetësore për qëllime ligjore (të drejtësisë).

“**Toksikologjia**” paraqet studimin e kundërefekteve të përbërjeve kimike në organizmat e gjallë”.

“**Histopatologjia**” nënkupton ekzaminimet mikroskopike të indeve me qëllim studimi manifestimin e sëmundjes.

“**Hetues mjekësor për raste të vdekjeve**” nënkuptohen profesionistet e trajnuar që marrin pjesë në vendin ku ka ndodhur vdekja, dokumentojnë, mbledhin, ruajnë dhe bartin evidencat fizike për analiza, lidhur me trupin (kufomën) apo të mbeturat mortore dhe i dërgojnë deri në fund çështjet siç është e nevojshme për të kuptuar në tërësi rrethanat e papritura, vdekjet e shkaktuara me dhunë dhe nga pakujdesia.

“**Persona të zhdukur**” janë personat vendndodhja e të cilëve është e panjohur.

“**Antropologjia Mjekoligjore**” është disiplinë për aplikimin e teknikave standarde të shkencës së antropologjisë fizike (trupore) për të identifikuar mbetjet mortore dhe asistuar në hetimet mjekësore për proceset gjyqësore.

“**Profili biologjiko-antropologjik**” është procedurë që konsiston në ekzaminimin e mbetjeve mortore, të kryer

LIGJI PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE

nga antropologu mjekoligjor me qëllim të dhënies së sugjerimeve mbi moshën, seksin(gjininë), origjinën, gjatësinë trupore dhe tiparet unike të të vdekurit bazuar në mbetjet mortore.

“**Arkeologjia mjeko-ligjore**” nënkupton aplikimin e metodave arkeologjike për të ndihmuar lokalizimin, zhvarrosjen dhe regjistrimin e te mbeturave mortore, për të ndihmuar në hetimet mjekësore në proceset gjyqësore.

“**Certifikata mjekësore mbi shkakun e vdekjes**”, nënkupton dokumentin formal që mund të përmbaj shkakun e vdekjes së trupit (kufomës) apo të mbetjeve mortore të lëshuar nga patologu mjekoligjor.

“**Certifikata e identifikimit**”, nënkupton dokumentin formal që identifikon trupin apo të mbetura mortore.

Neni 3 Kompetencat

Departamenti i Mjekësisë Ligjore është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit mjekoligjor bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikata më të mira Europiane për të siguruar shërbime mjeko ligjore, mësimdhënie dhe shërbime përkrahëse për familjet e personave të zhdukur.

Neni 4 Struktura Organizative e Departamentit për Mjekësi Ligjore

1. Departamenti i Mjekësisë Ligjore themelohet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Instituti i Mjekësisë Ligjore i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore i Ministrisë së Drejtësisë do të shkrihen në Departamentin për Mjekësi Ligjore.
3. Departamenti përbëhet nga këto divizione:
 - 3.1. Divizioni për Mjekësi Ligjore;
 - 3.2. Divizioni për hulumtime dhe ndërtimin e kapaciteteve;
 - 3.3. Divizioni për Identifikim, Koordinim dhe Përkrahje;

4. Përbrenda Divizioneve që janë në kuadër të Departamentit për Mjekësi Ligjore do të themelohen sektorë dhe shërbime të veçanta si në vijim:

- 4.1. Në kuadër të Divizionit për Mjekësi Ligjore do të themelohen sektoret punuese siç vijon:

- 4.1.1. Sektori i autopsisë;
- 4.1.2. Sektori për ekzaminime (këqyrje) klinike;
- 4.1.3. Sektori për hetimin mjekësor të vdekjeve;
- 4.1.4. Sektori për Antropologji dhe Arkeologji Mjeko-Ligjore;
- 4.1.5. Laboratori për Toksikologji Mjeko-Ligjore;
- 4.1.6. Laboratori për Histopatologji Mjeko-Ligjore;
- 4.1.7. Sektori për Fotografi Mjekoligjore;
- 4.1.8. Sektori për sigurimin e kualitetit;
- 4.1.9. Sektori për dokumente Konfidenciale;

- 4.2. Përbrenda Divizionit për Hulumtime dhe Ndërtimin e Kapaciteteve do të themelohen sektorët punues siç vijon:

- 4.2.1. Sektori i Anatomisë Njerëzore dhe trajnimeve specializuese të Mjekësisë Ligjore;
- 4.2.2. Sektori i trajnimeve të specializuara, për hetime në fushën e Mjekësisë Ligjore;
- 4.2.3. Sektori për Akreditim dhe Certifikim;
- 4.2.4. Sektori për hulumtime dhe statistikë;

- 4.3. Përbrenda Divizionit për Koordinim, Identifikim dhe Përkrahje do të themelohen sektorët siç vijon:

- 4.3.1. Sektori për hulumtimet në komunitet;
- 4.3.2. Sektori për zhvarrosje, identifikim, koordinim dhe përkrahje;
- 4.3.3. Projektet e Kujtesës/Projekt Psiko-Social;
- 4.3.4. Sektori për mbështetjen/përkrahjen e familjeve;
- 4.3.5. Sektori për ndërlidhje.

- 4.4. Departamenti për Mjekësi Ligjore do të jetë i vendosur në Prishtinë.

LIGJI PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE**Neni 5****Personali i Departamentit për Mjekësi Ligjore**

1. I gjithë personeli i Departamentit të Mjekësisë Ligjore do të përzgjidhen dhe shkarkohen nga puna në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shërbyes civil.

Neni 6**Kompetencat dhe përgjegjësitë e Divizionit**

1. Kompetencat e Divizionit të Mjekësisë Ligjore përbajnë por nuk kufizohen në:
 - 1.1. Mbajtjen e të drejtës për të siguruar ekspertizë mjekoligjore për organet publike;
 - 1.2. Mbajtjen e të drejtës ekskluzive për të udhëhequr hetimet mjekësore për vdekjen në vendin e ngjarjes;
 - 1.3. Mbajtjen e të drejtës ekskluzive për të kryer ekshumime (zhvarrosje) në pajtim me Kodin e Procedurës Penale;
 - 1.4. Mbajtjen e të drejtës ekskluzive për të kryer inspektime post-mortem (pas vdekjes) dhe autopsi në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, si dhe ekzaminimin e viktimave që kanë pësuar nga veprat penale kundër jetës dhe trupit siç përcaktohet në Kodin Penal të Kosovës;
 - 1.5. Mbajtjen e të drejtës ekskluzive që të përcakton seksin (gjininë), racën, gjatësinë, moshën, dhe shkakun e vdekjes të mbetjeve mortore të një personi të pa identifikuar kurdoherë që është e mundur;
 - 1.6. Kryerjen e autopsisë dhe/ose profilin antropologjik dhe lëshon raport të autopsisë në raste të zbulimit të mbetjeve mortore në juridiksionet e huaja dhe të transportuara për në Republikën e Kosovës;
 - 1.7. Mbajtjen e të drejtës ekskluzive për koordinimin dhe udhëheqjen e ekzaminimeve klinike për viktima, dëshmitar dhe autorët e mundshëm (supozuar) të krimit kundër integritetit seksual, mbështetur në Kapitullin XIX të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;
 - 1.8. Kërkimin e dokumenteve mjekësore që kanë të bëjnë me viktimën dhe/ose pandehurin për krimet kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës;
 - 1.9. Mbledh ose ekzaminon dëshmitë e gjetura nga viktimat, dëshmitarët, apo të pandehurit

e krimeve kundër integritetit seksual dhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, bazuar në Kodin Penal të Kosovës.

2. Kompetencat e Divizionit për Hulumtime dhe Ndërtim të Kapaciteteve do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në :
 - 2.1. trajnimin dhe përgatitjen e praktikantëve të mjekësisë ligjore, infermiereve mjekoligjore, hetuesve mjekësor të vdekjeve, teknikëve të laboratorit të mjekësisë ligjore, fotografëve të mjekësisë ligjore, asistentëve teknik të mjekësisë ligjore, zyrtarëve mjekoligjor për identifikim, teknikëve të histopatologjisë dhe teknikëve të autopsisë;
 - 2.2. mësimdhënien për studentët dhe studentët e diplomuar në fushën e anatomisë njerëzore dhe mjekësisë ligjore;
 - 2.3. mbajtjen e dokumenteve për procedurat standarde operative, evidencën e inspektimit dhe mënyrën e mbrojtjes.

3. Kompetencat e Divizionit për Koordinimin, Identifikimin dhe Përkrahjen e Familjeve do të përfshijnë por nuk do të kufizohen në :
 - 3.1. mbledhjen dhe menaxhimin e informatave lidhur me vendndodhjen e personave të zhdukur dhe varrezave të mundshme;
 - 3.2. kryerjen e vizitave tek familjet e personave të zhdukur për të mbledhur informacionet e nevojshme lidhur me personat e zhdukur;
 - 3.3. përcaktimin e identitetit të personit të zhdukur në çdo mënyrë;
 - 3.4. kthimin e mbetjeve mortore të identifikuara tek familjet e personave të zhdukur dhe/ose arranzhimin e rivarrimit, kur është e nevojshme;
 - 3.5. koordinimin dhe komunikimin me familjet e personave të zhdukur duke i vënë në kontakt me organizatat dhe institucionet vendore e ndërkombëtare;
 - 3.6. sigurimin e informatave nga baza e të dhënave për Komisionin Funkcional Parlamentar;
 - 3.7. lëshon certifikata identifikimi;
 - 3.8. bën kthimin e gjërave personale tek familjet së bashku me listën e plotë të nënshkruar.

LIGJI PËR DEPARTAMENTIN E MJEKËSISË LIGJORE**Neni 7
Dispozitat Kalimtare**

Personeli, buxheti i alokuar, prona, arkiva, të dhënat (evidencat) dhe pajisjet tjera të Institutit për Mjekësi Ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë do të bartet (transferohet) nga Ministria e Shëndetësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

**Neni 8
Dispozitat e EULEX-it**

1. Gjatë kohëzgjatjes së Misionit të EULEX-it në Kosovë, ekspertët e EULEX-it në Departamentin e Mjekësisë Ligjore do të monitorojnë, udhëzojnë dhe këshilloj ekspertët vendor në Departament gjatë punës së tyre në ekipe të përziera.
2. Ekspertët e EULEX-it do të punojnë ngushtë me autoritetet vendor për të zhvilluar kapacitetet vendore dhe për të siguruar se Departamenti i Mjekësisë Ligjore të ketë ekspertë të mjaftueshëm, të trajnuar mirë dhe të aftë për kryerjen e ekspertizës mjeko ligjore që i plotëson standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira europiane:
 - 2.1. Ekspertët e EULEX-it do të kryejnë çdo lloj të ekzaminimit mjeko ligjor duke përfshirë autopsitë në ekipe të përziera me ekspertë mjeko ligjor vendor.
 - 2.2. Ekspertët e EULEX-it në Departamentin e Mjekësisë Ligjore do të marrin pjesë në çdo lloj të ekzaminimeve mjeko ligjore, duke përfshirë autopsitë në të gjitha rastet kur një prokuror i EULEX-it është caktuar në procedura penale në pajtim me nenin 8 të Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe në të gjitha rastet kur një gjyqtar i EULEX-it është caktuar në procedura penale në pajtim me nenin 3 dhe 4 të Ligjit për kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.
3. Pjesëtarët e personelit të Misionit të EULEX-it do të bashkë-vendosen në objektet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.
 - 3.1. Misioni i EULEX-it në Kosovë do të caktojë një Bashkëkryesues të EULEX-it për Depar-

tamentin e Mjekësisë Ligjore i cili do të jetë përgjegjës që së bashku me Drejtorin vendor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore të përcaktojë politikën udhëheqëse dhe zhvillimin e strategjisë në fushën e Mjekësisë Ligjore.

- 3.2. Bashkëkryesuesi i EULEX-it i Departamentit të Mjekësisë Ligjore do të jetë përgjegjës për menaxhimin e personelit të EULEX-it të vendosur në Departamentin e Mjekësisë Ligjore.
- 3.3. Menaxhimi operacional, ndarja e punës dhe përbërja e ekipeve të përziera do të rregullohen me anë të një Marrëveshje ndërmjet Bashkëkryesuesit të EULEX-it të Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorit vendor të Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

**Neni 9
Shfuqizimi**

Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat ligjore të cilat janë në kundërshtim me të.

**Neni 10
Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren nga Ministria e Drejtësisë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 11
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-137
25 qershor 2009**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2009, datë
17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.**

LIGJI PËR LIZINGUN

Ligji Nr. 03/L-103

PËR LIZINGUN

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Miraton

LIGJ PËR LIZINGUN

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fusha e veprimit

1. Ky ligj rregullon lizingun e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, si financiar ashtu edhe operativ dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve të lizingut.
2. Ky ligj nuk zbatohet për qiranë e tokës, qiranë e ndërtesave, qiranë e zyreve ose apartamenteve dhe nuk do të zbatohet për lizingun ose qiranë e mallrave të paqëndrueshme (jo të përjetshme), parave, dokumenteve, instrumenteve financiare, llogarive, letrave me vlerë, veprave të artit, pronës intelektuale ose pronës tjetër të paprekshme.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllime të këtij ligjit termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

“**Aset**” nënkupton çdo mall të luajtshëm ose të paluajtshme të qëndrueshëm. Ky term nuk përfshin mallrat e paqëndrueshme, paratë, dokumentet, instrumentet financiare, llogaritë, letrat komerciale, letrat me vlerë, veprat e artit, pronën intelektuale ose pronën tjetër të paprekshme.

“**Lizing financiar**” nënkupton një marrëdhënie financiare në të cilën lizingdhënësi hyn në një marrëveshje me shkrim me lizingmarrësin e cila i jep lizingmarrësit të drejtën e posedimit dhe përdorimit të Asetit Objekt Lizingu për periudhën e caktuar të kohës në këmbim të pagesës nga lizingmarrësi të kësteve të përcaktuara, me ose pa opsionin për blerje, që përfshin karakteristikat e mëposhtme:

1. Lizingmarrësi përcakton Asetin Objekt Lizingu dhe zgjedh Furnizuesin; dhe
2. Lizingdhënësi përfiton Asetin Objekt Lizingu ose të drejtën e posedimit dhe përdorimit të Asetit Objekt Lizingu në lidhje me një lizing dhe Furnizuesi ka qenë i njoftuar nga lizingdhënësi ose lizingmarrësi ose në ndonjë mënyrë tjetër ka pas njohuri për këtë fakt dhe lizingu i përmbush një ose më shumë nga kriteret si në vijim:
 - 2.1 e drejta në asetet e lizingut kalon menjëherë nga lizingdhënësi në lizingmarrësin në fund të kohëzgjatjes së Lizingut;
 - 2.2 lizingu përmbanë një opsion të volitshëm të blerjes nën të cilën lizingmarrësi mund të fitoj (marr) asetet e lizingut më pak se sa vlera reale e tregut në fund të kohëzgjatjes së lizingut;
 - 2.3 kohëzgjatja e lizingut është për periudhën më të gjatë se 75 përqind e qëndrueshmërisë ekonomike të aseteve të dhëna me lizing; ose
 - 2.4 vlera aktuale e pagesës së lizingut është më e madhe se 90 përqind e vlerës reale të tregut të aseteve, që është në fillimin e kohëzgjatjes së lizingut.

“**Aset i dhënë me lizing**” nënkupton një aset i cili është objekt i një Marrëveshje të Lizingut.

“**Lizingmarrës**” nënkupton një person fizik ose juridik, i cili përfiton të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të Asetit Objekt Lizingu nga lizingdhënësi në bazë të Kontratës së Lizingut. Përveç kur tregohet ndryshe nga konteksti, përkufizimi përfshin nën-lizingmarrësin.

“**Lizingdhënësi**” nënkupton një person juridik i licencuar në mënyrë të posaçme nga Banka Qendrore e Kosovës për të ushtruar në mënyrë të ndërsjellët transaksionet e Lizingut Financiar dhe/ose Lizingut Operativ dhe i cili jep të drejtën e posedimit ose të shfrytëzimit të Asetit Objekt

Lizingu në bazë të Kontratës së Lizingut. Përveç kur nga konteksti nënkuptohet ndryshe, përkufizimi përfshin nën-lizingdhënësin.

“**Lizingu Operativ**” nënkupton transaksionet e lizingut të cilat nuk i plotësojnë asnjë nga kriteret e përcaktuara në paragrafin 2.1 deri 2.4 të përkufizimit të Lizingut Financiar të cekur më lartë.

“**Furnizues**” nënkupton një person nga i cili lizingdhënësi merr Asetin Objekt Lizingu ose të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të një Aseti Objekt Lizingu në bazë të një Kontrate Furnizimi.

“**Kontratë e Lizingut**” nënkupton kontratën e lidhur mes lizingdhënësit dhe lizingmarrësit, e cila i jep lizingmarrësit të drejtën e posedimit dhe shfrytëzimit të Asetit Objekt Lizingu për periudhën e caktuar kohore, me marrëveshje, në këmbim të pagesës nga lizingmarrësi të kësteve të përcaktuara.

“**Kontratë e Furnizimit**” nënkupton kontratën sipas së cilës lizingdhënësi e përfiton Asetin Objekt Lizingu për t’ia dhënë me qira lizingmarrësi .

“**Personi i besuar në falimentim**” përfshin një likuidator, administrator, menaxher të jashtëm ose ndonjë person tjetër të caktuar për të administruar pasurinë e lizingmarrësi në interes të trupit të përgjithshëm të kreditorëve.

“**Afati i lizingut**” është periudha fillimisht siç përcaktohet në Kontratën e Lizingut, gjatë të cilës lizingmarrësi ka të drejtë të posedojë dhe të shfrytëzojë Asetin Objekt Lizingu dhe që nuk mund të jetë më pak se një vit dhe jo më gjatë se qëndrueshmëria ekonomike e asetit objekt lizingu.

KREU II PALËT NË NJË MARRËDHËNIE TË LIZINGUT

Neni 3

Palët në marrëdhënien e Lizingut

1. Palët në marrëdhënien e Lizingut janë: Lizingdhënësi, Lizingmarrësi dhe në disa raste përfshin edhe Furnizuesin.

2. Lizingdhënësi dhe Furnizuesi mund të jetë person i njejtë.

KREU III KONTRATA E LIZINGUT

Neni 4

Forma e Kontratës së Lizingut

Kontrata e Lizingut duhet të bëhet në formë të shkruar në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi, që rregullon termat dhe kushtet e palëve në lidhje me Asetin Objekt Lizingu.

Neni 5

Përmbajtja e Kontratës së Lizingut

1. Kontrata e Lizingut përmban minimumin e dispozitave të mëposhtme:

- 1.1. identitetin dhe adresat e palëve në Kontratën e Lizingut;
- 1.2. përshkrimin e Asetit Objekt Lizingu, i mjaftueshëm për të mundësuar identifikimin e tij, ose në kohën e themelimit të Kontratës së Lizingut ose më vonë;
- 1.3. kohëzgjatja e afatit të Lizingut nuk mund të jetë më pak se një vit dhe jo më gjatë se qëndrueshmëria ekonomike e Asetit Objekt Lizingu;
- 1.4. shumën totale të të gjitha pagesave për t’u paguar nga lizingmarrësi;
- 1.5. numrin, shumat dhe afatet e çdo pagese periodike;
- 1.6. një përshkrim të kushteve të ndonjë opsioni ose për të blerë asetet e dhëna me lizing ose për të ripërtitur Kontratën e Lizingut për një periudhë shtesë;
- 1.7. identitetin e furnizuesit dhe referencën tek Kontrata e Furnizimit, nëse është lidhur një Kontratë Furnizimi e veçantë.

2. Përveç dispozitave të referuara në paragrafin 1 të këtij neni, Kontrata e Lizingut mund të përmbajë pika të tjera për të cilat palët mund të pajtohen.

LIGJI PËR LIZINGUN

3. Kontrata e Lizingut mund të jetë:

- 3.1. Vendore: të dy palët e Kontratës së Lizingut janë rezidentë të Kosovës;
- 3.2. Ndërkombëtare: ose lizingdhënësi ose lizingmarrësi nuk është rezident i Kosovës.

KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE NË KONTRATËN E LIZINGUT

Neni 6 Parevokueshëria

Në marrëdhënien e Lizingut detyrimet e lizingdhënsi dhe lizingmarrësit janë të pakthyeshme dhe të pavarura nga koha kur palët hyjnë në një Kontratë Lizingu. Këto detyrime nuk mund të anulohen ose modifikohen pa pëlqimin e shprehur të palës tjetër.

Neni 7 Të drejtat e pronësisë së lizingdhënësit

1. Lizingdhënësi ruan të drejtën e tij të pronësisë mbi Asetin Objekt Lizingu gjatë afatit të lizingut dhe më pas deri sa mbartja e të drejtës së pronësisë të vërtetohet në mënyrë të dokumentuar. E drejta e pronësisë së lizingdhënësit është e vlefshme kundër të besuarit të lizingmarrësit në falimentim dhe kreditorëve, përveç nëse një person gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij të rregullt afariste furnizon me shërbime ose materiale në lidhje me asetet objekt lizingu. Obligimet eventuale kanë përparësi ndaj të drejtës së pronësisë së lizingmarrësit.
2. Lizingdhënësi e ruan të drejtën e tij të pronësisë mbi Asetin Objekt Lizingu gjatë gjithë kohës, pavarësisht masës së ndonjë bashkëngjitjeje në të ose inkorporimit si pjesë e një pasurie tjetër të luajtshme apo të paluajtshme, dhe do të ketë të drejtë riposidimi të aseteve objekt lizingu, përveç nëse me Kontratën e Lizingut është paraparë ndryshe, edhe nëse heqja e Asetit Objekt Lizingu do të shkaktonte dëme të riparueshme tek pasuria tjetër. Lizingdhënësi nuk ka përgjegjësi për ndonjë dëm ose dëmtim tjetër të shkaktuar nga kjo heqje me kusht që lizingmarrësi do të ushtroj kujdesin e arsyeshëm për të mënjanuar këtë dëm ose cenim tjetër të pronës së tillë.

Neni 8 Pranimi i Asetit Objekt Lizingu

1. Pranimi i Asetit Objekt Lizingu bëhet kur lizingmarrësi i tregon lizingdhënësit ose në rastet e marrëdhënies të Lizingut Financiar, lizingdhënësit dhe furnizuesit, që Aseti Objekt Lizingu është në pajtueshmëri me Kontratën e Lizingut, deklaron se lizingmarrësi do të mbajë atë me gjithë mospërputhshmërinë, ose nuk e refuzon Asetin Objekt Lizingu pas një mundësie të arsyeshme për ta inspektuar atë, ose e përdor Asetin Objekt Lizingu.
2. Pranimi bëhet me anë të lëshimit të një dokumenti ku bëhet njohja e pranimit ose në mënyra të tjera të përcaktuara në Kontratën e Lizingut midis palëve.
3. Sapo lizingmarrësi në një marrëdhënie të Lizingut pranon Asetin Objekt Lizingu, lizingmarrësi ka të drejtën e dëmshpërblimit nga furnizuesi nëse Aseti nuk është në pajtueshmëri me Kontratën e Furnizimit.

Neni 9 E drejta e lizingmarrësit të refuzojë Asetin Objekt Lizingu

1. Kur Aseti Objekt Lizingu nuk dorëzohet ose dorëzohet me vonesë, ose nuk është në pajtueshmëri me Kontratën e Furnizimit atëherë në ose gjatë kohës së pranimit, por jo më vonë, lizingmarrësi ka të drejtë:
 - 1.1. të refuzojë Asetin Objekt Lizingu, me ç'rast lizingmarrësi do të lirohet nga detyrimet e veta nga Kontrata e Lizingut; ose
 - 1.2. t'i kërkojë furnizuesit të eliminojë defektet e Asetit Objekt Lizingu.
2. Lizingmarrësi nuk do të ketë pretendime të tjera kundër lizingdhënësit për mosdorëzim, vonesë në dorëzim ose dorëzim të Asetit Objekt Lizingu në pajtueshmëri, përveç në masën që këto rezultojnë nga vonesa e lizingdhënësit.
3. Në marrëdhëniet e Lizingut Financiar, asgjë në këtë nen nuk ndikon tek të drejtat e lizingmarrësit kundër furnizuesit siç parashihet në nenin 24 të këtij ligji.

Neni 10**Shpërndarja e rreziqeve, përgjegjësia për dëmin**

1. Në marrëdhëniet e lizingut, lizingmarrësi mban rrezikun e humbjes ose dëmtimit të Asetit Objekt Lizingu nga koha e pranimit të tij derisa ai t'i kthehet lizingdhënësit.
2. Lizingmarrësi ka përgjegjësi për dëmet e pësuar nga shfrytëzimi i Asetit Objekt Lizingu në kundërshtim me Kontratën e Lizingut, ose në kundërshtim me qëllimin përdorimit të Asetit Objekt Lizingu, pavarësisht nëse lizingmarrësi e ka shfrytëzuar personalisht Asetin Objekt Lizingu apo një person i autorizuar nga lizingmarrësi, ose ndonjë person tjetër që lizingmarrësi i kanë dhënë leje për ta shfrytëzuar Asetin Objekt Lizingu.
3. Lizingmarrësi është përgjegjës për dëmet e pësuar nga lizingdhënësi në rastin kur Aseti Objekt Lizingu i kthehet lizingdhënësit në një gjendje që nuk përkon me nenin 16 paragrafi (3) të këtij ligji .

Neni 11**Sigurimi**

1. Në marrëdhëniet e Lizingut Financiar, përveç nëse me Kontratën e Lizingut parashihet ndryshe, lizingdhënësi ka të drejtë t'i kërkojë lizingmarrësit të sigurojë dhe mbajë prova të sigurimit për Asetin Objekt Lizingu për kohëzgjatjen e lizingut, duke filluar që nga momenti i pranimit të Asetit Objekt Lizingu nga lizingmarrësi, përveç nëse parashihet ndryshe në Kontratën e Lizingut.
2. Lizingdhënësi mund ta bëjë sigurimin vetë nëse lizingmarrësi nuk e bën këtë dhe në rast të tillë, me dëshminë e pagesës për këtë sigurim, lizingmarrësi duhet të rimburson menjëherë lizingdhënësin për koston e shkaktuar në lidhje me këtë sigurim, përveç nëse parashihet ndryshe me Kontratën e Lizingut.
3. Në marrëdhëniet e Lizingut Operativ, lizingdhënësi duhet të sigurojë Asetet Objekt Lizingu, përveç nëse parashihet ndryshe me Kontratën e Lizingut.

Neni 12**Përfshirja e përgjegjësive të lizingdhënësit**

1. Në marrëdhëniet e Lizingut Financiar, lizingdhënësi nuk ka përgjegjësi ndaj lizingmarrësit në lidhje me të metat materiale të Asetit Objekt Lizingu.
2. Në marrëdhëniet e Lizingut Operativ, lizingdhënësi është përgjegjës ndaj lizingmarrësit për mungesat materiale të aseteve objekt lizingu, përveç nëse parashihet ndryshe me Kontratën e Lizingut.
3. Lizingdhënësi, në cilësinë e tij si lizingdhënësi, nuk është përgjegjës tek palët e treta për vdekjen, dëmtimin personal ose dëmin e pronës të shkaktuar nga Aseti Objekt Lizingu ose nga përdorimi i këtij asemi.

Neni 13**Garancia për posedim të qetë**

1. Lizingdhënësi garanton që posedimi i qetë i lizingmarrësit nuk do të shqetësohet nga ndonjë person, i cili ka titull ose të drejtë superiore ose që pretendon një titull ose të drejtë superiore ose vepron nën autoritetin e një gjykate, kur ky titull, e drejtë ose pretendim buron nga një veprim ose mosveprim neglizhent ose i qëllimshëm i lizingdhënësit.
2. Në rast të shqetësimit të posedimit të qetë nga lizingmarrësi, lizingmarrësi ka të drejtën e dëmshpërblimit nga lizingdhënësi.
3. Palët nuk mund të heqin dorë ose të ndryshojnë efektin e dispozitave të këtij neni.

Neni 14**E drejta e lizingdhënësit për t'u informuar**

1. Lizingdhënësi mund kohë pas kohe të kërkojë nga lizingmarrësi që ta informojë atë në lidhje me ndonjë humbje, pretendim, dëm ose ngjarje tjera materiale që dalin në lidhje me shfrytëzimin dhe posedimin nga lizingmarrësi të Asetit Objekt Lizingu. Lizingmarrësi duhet ta japë këtë informacion në mënyrë të saktë dhe në kohën e duhur.
2. Lizingmarrësi informon lizingdhënësin në lidhje me vendndodhjen e Asetit Objekt Lizingu dhe nuk e lëviz atë në një vend-ndodhje të re pa pëlqimin paraprak me shkrim të lizingdhënësit.

LIGJI PËR LIZINGUN**Neni 15****E drejta e lizingdhënësit të inspektojë Asetin Objekt Lizingu, Etiketat dhe Regjistrimi**

1. Lizingdhënësi ka të drejtë të kryejë inspektimin e Asetit Objekt Lizingu në çdo kohë gjatë afatit të lizingut. Inspektimi nuk cenon garancinë e lizingdhënësit për shfrytëzim dhe posedim të qetë. E drejta për të inspektuar nuk do të përdoret si mënyrë për të ndërhyrë në ndonjë aspekt të së drejtës së posedimit të lizingmarrësit.
2. Kontrata e Lizingut mund të parasheh që gjatë kohëzgjatjes së lizingut Aseti Objekt Lizingu të etiketohet si në pronësi të lizingdhënësit, apo objekt lizingu i dhënë nga lizingdhënësi, si dhe këto etiketa nuk mund të hiqen apo ndryshohen për gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Lizingut nga asnjë person tjetër përveç lizingdhënësit apo agjentit të tij të autorizuar.
3. Ekzistimi i Kontratës së Lizingut në lidhje me një Aset Objekt Lizingu mund të regjistrohet në ndonjë regjistër të përshtatshëm për këtë pronë, por pa u kufizuar vetëm në Zyrën për Regjistrimin e Pengut për pasuritë e luajtshme të themeluar në bazë të legjislacionit në fuqi, në regjistrin për Mjetet Motorike, regjistrin e pasuritë e paluajtshme/tokës ose ndonjë regjistër tjetër të pronësisë intelektuale.

Neni 16**Mirëmbajtja e Asetit Objekt Lizingu**

1. Lizingmarrësi tregon kujdesin e duhur për Asetin Objekt Lizingu dhe e përdor atë në mënyrë të arsyeshme në pajtim me karakteristikat dhe qëllimin e tij dhe në pajtueshmëri me ligjet, dhe aktet e tjera juridike.
2. Kur prodhuesi ose Furnizuesi i Asetit Objekt Lizingu nxjerr udhëzime teknike për shfrytëzimin e Asetit Objekt Lizingu, lizingmarrësi duhet t'u përmbahet këtyre udhëzimeve.
3. Lizingmarrësi e mban Asetin Objekt Lizingu në gjendjen në të cilën i është dorëzuar varësisht nga konsumi dhe përdorimi i zakonshëm.
4. Në marrëdhëniet e Lizingut Financiar, lizingmarrësi gjithashtu mirëmban dhe riparon me shpenzimet e

tij Asetin Objekt Lizingu dhe e mban atë në gjendje të mirë pune, përveç nëse Kontrata e Lizingut parashihet ndryshe.

5. Në marrëdhëniet e Lizingut Operativ, lizingdhënësi duhet të mirëmbajë dhe riparoj me shpenzimet e tij Asetin e Objektivit të Lizingut dhe të mbajë atë në gjendje të mirë pune, përveç nëse me Kontratën e Lizingut parashihet ndryshe.

Neni 17**Përmirësimet në Asetin Objekt Lizingu**

1. Nëse rregullohet ndryshe në Kontratën e Lizingut, në rastet kur Aseti Objekt Lizingu për çfarëdo lloj arsye i kthehet lizingdhënësit nga lizingmarrësi zbatohen dispozitat e mëposhtme:
 - 1.1. çdo përmirësim në Asetin Objekt Lizingu i cili mund të shkëputet nga ky aset pa shkaktuar dëme në të (përmirësimet e shkëputshme) dhe që janë bërë nga lizingmarrësi me shpenzimet e tij mbeten pronë e lizingmarrësit;
 - 1.2. kur lizingmarrësi me pëlqimin me shkrim të lizingdhënësit dhe me shpenzimet e tij ka bërë përmirësime në Asetin Objekt Lizingu, të cilat nuk mund të shkëputen nga Aseti i Lizingut pa shkaktuar dëme në të (përmirësimet e pashkëputshme), lizingmarrësi ka të drejtën e kompensimit për koston e këtyre shpenzimeve; dhe
 - 1.2.1. kostoja e përmirësimeve të pashkëputshme që janë bërë nga lizingmarrësi me shpenzimet e tij pa pëlqimin me shkrim të lizingdhënësit, nuk do të kompensohet.

Neni 18**Pengu i Asetit Objekt Lizingu**

Lizingmarrësi nuk mund të lërë peng, të vërë hipotekë ose në ndonjë mënyrë tjetër të ngarkojë me një detyrim ose barrë Asetin Objekt Lizingu. Ndonjë veprim i tillë do të shkaktoj mosplotësim të Kontratës së Lizingut.

Neni 19
Bartja e të drejtave

1. Lizingmarrësi mund ta bartë ose të disponojë në ndonjë mënyrë tjetër me të gjitha ose ndonjë prej të drejtave të tij për Asetin Objekt Lizingu ose sipas Kontratës së Lizingut, vetëm me pëlqimin me shkrim të lizingdhënësit dhe në vartësi të të drejtave të personave të tretë.
2. Lizingdhënësi mund të bartë ose të veprojë në ndonjë mënyrë tjetër me të gjitha ose ndonjë prej të drejtave të tij mbi Asetin Objekt Lizingu ose sipas Kontratës së Lizingut pa pëlqimin e lizingmarrësit. Kjo bartje nuk e liron lizingdhënësin nga asnjë prej përgjegjësive të tij ose ndryshon natyrën e Kontratës së Lizingut. Bartja e të drejtave të lizingdhënësit mund të përjashtohet ose kufizohet nga Kontrata e Lizingut.

Neni 20
Kthimi i Asetit Objekt Lizingu

1. Në rast se Kontrata e Lizingut përfundon dhe lizingmarrësi nuk ushtron të drejtën për të marr Asetin e Lizingut në marrëdhënie të një lizingu Financiar, të blejë Asetin Objekt Lizingu në marrëdhënie të një lizingu Operativ, ose të ripërtërijë Kontratën e Lizingut, atëherë lizingmarrësi e kthen Asetin Objekt Lizingu në të njëjtën gjendje në të cilën i është dorëzuar, përveç konsumit dhe përdorimit të zakonshëm ose siç përcaktohet në Kontratën e Lizingut.
2. Në mungesë të specifikacionit në Kontratën e Lizingut ose njoftimit tek lizingmarrësi, Aseti Objekt Lizingu do të kthehet në adresën e lizingdhënësit të treguar në Kontratën e Lizingut.
3. Në rastet kur lizingmarrësi nuk e kthen Asetin Objekt Lizingu në kohë ose e kthen atë me vonesë, lizingmarrësi do të jetë përgjegjës për pagesën për periudhën e vonesës, përveç nëse parashihet ndryshe në Kontratën e Lizingut.
4. Në rastet kur kthimi me vonesë i Asetit Objekt Lizingu ka shkaktuar një gjobë ose detyrim tjetër për t'u paguar nga lizingdhënësi, lizingmarrësi i rimbursion lizingdhënësit shumën e çdo gjobe ose ngarkese të paguar, përveç nëse parashihet ndryshe në Kontratën e Lizingut.

KREU V
VONESA E PALËVE NË KONTRATËN E LIZINGUT

Neni 21
E drejta e lizingdhënësit në rast vonese nga lizingmarrësi

1. Në rast të vonesës nga ana e lizingmarrësit, lizingdhënësi mund të përfitojë këstet e grumbulluara të papaguara të lizingut, së bashku me interesin dhe dëmet.
2. Kur vonesa e lizingmarrësit është materiale, atëherë lizingdhënësi mund të kërkojë pagesë të shtuar të kësteve të ardhshme të lizingut ose mund të përfundojë Kontratën e Lizingut dhe pas këtij përfundimi mund:
 - 2.1. të rimarrë posedimin e Asetit Objekt Lizingu; dhe
 - 2.2. të përfitojë ato dëme që do ta vinin lizingdhënësin në pozitën në të cilën do të ishte nëse lizingmarrësi do ta përmbushte Kontratën e Lizingut në pajtim me kushtet e saj, duke përfshirë dëmet e rastësishme siç janë detyrimet, shpenzimet ose komisionet e shkaktuara në ndaljen e dërgesave në transport, përkujdesje dhe ruajtje të Aseteve Objekt Lizingu pas vonesës së lizingmarrësit në lidhje me kthimin ose depozitimin e Asetit të Lizingut.
3. Kontrata e Lizingut mund të përkufizojë rrethanat kur vonesa, duke përfshirë edhe shtyrjen e pagesës, konsiderohet materiale.
4. Lizingdhënësi mund të mos ushtrojë të drejtat e tij sipas paragrafit 2 të këtij neni përveç nëse ka dërguar një njoftim me shkrim për vonesën materiale tek lizingmarrësi dhe lizingmarrësi nuk e ka korrigjuar këtë vonesë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas marrjes së këtij njoftimi.

Neni 22
Riposedimi i Asetit Objekt Lizingu

1. Riposedimi i Asetit Objekt Lizingu siç parashihet nga neni 21 paragrafi 2.1. mund të realizohet:

LIGJI PËR LIZINGUN

- 1.1. me akt gjyqësor;
 - 1.2. nga vetë lizingdhënësi, nëse kjo mund të bëhet pa prishur qetësinë publike; ose
 - 1.3. me akt administrativ, në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni.
2. Nëse lizingdhënësi procedon me veprim gjyqësor, ai duhet të parashtrojë një kërkesë në gjykatën e juridiksionit kompetent duke kërkuar një urdhër, ex parte dhe pa paralajmërim tek lizingmarrësi ose ndonjë person tjetër, duke autorizuar lizingdhënësin ose agjentin e autorizuar të tij të riposedoj Asetin Objekt Lizingu dhe t'i dorëzohet lizingdhënësit. Kjo parashtrësë do të vendoset nga gjykata jo më vonë se tri (3) ditë pune pas datës së dorëzimit të kërkesës.
 3. Brenda afatit prej tri (3) ditësh pas riposedimit të Asetit Objekt Lizingu, lizingmarrësi mund të parashtrojë një mocion për të kundërshtuar riposedimin në tërësi ose të pjesshëm, duke dhënë prova të mungesës së veprimit nën Kontratën e Lizingut duke përfshirë pagesat e kësteve dhe/ose prova të tjera në mbështetje të kundërshtimit. Pastaj, gjykata ose ndonjë organ tjetër kompetent duhet të vendos nëse duhet revokuar apo ndryshuar ndonjë urdhër i nxjerrë në bazë të Paragrafit 2 të këtij neni dhe nëse urdhri i tillë është revokuar do të përcakton përgjegjësinë e lizingdhënësit për ndonjë dëm të shkaktuar nga urdhri për të riposedimin dhe dorëzimin e Asetit Objekt Lizingu.
 4. Lizingdhënësi në rast vonese të lizingmarrësit mund të emërojë një person të zgjedhur nga gjykata për të marrë posedimin e Asetit Objekt Lizingu kur:
 - 1.1. Lizingdhënësi nuk ka të drejtë të hyjë në vendin ku ndodhet Aseti Objekt Lizingu;
 - 1.2. kur të drejtat e posedimit të lizingdhënësit cenohen nga Lizingmarrësi ose ndonjë person tjetër; dhe
 - 1.3. kur mund të ketë prishje të qetësisë publike nëse lizingdhënësi është përpjekur vetë të marrë ripoesdimin.
 5. Brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas riposedimit ose marrjes së Asetit Objekt Lizingu nga lizingmarrësi, lizingmarrësi mund të kërkojë nga lizingdhënësi ta rikthejë Asetin Objekt Lizingu duke plotësuar të gjitha detyrimet në bazë të Kontratës

së Lizingut si dhe të gjitha shpenzimet e shkaktuara, dënimet ose dëmet që ndërlidhen me mosplotësimin e Kontratës së Lizingut dhe riposedimin e Asetit Objekt Lizingu me kusht që lizingmarrësi t'i përmbush të gjitha detyrimet e tij sipas Kontratës së Lizingut para se lizingdhënësi ta kthejë asetin objekt lizingu te lizingmarrësi.

Neni 23**E drejta e lizingmarrësit në rast të vonesës së lizingdhënësit**

1. Në marrëdhëniet e Lizingut Financiar, përveç nëse parashihet ndryshe me Kontratën e Lizingut, lizingmarrësi nuk mund të ndërprejë Kontratën e Lizingut në rast të cenimit të Kontratës së Lizingut nga lizingdhënësi, por ka të drejtën e mjeteve të tjera juridike për dëmshpërblim siç parashihet në Kontratën e Lizingut dhe me ligj.
2. Në marrëdhëniet e Lizingut Operativ, lizingmarrësi mund të ndërprejë Kontratën e Lizingut në rastet e dëmeve materiale të shkaktuara në lizingdhënësi, përveç nëse me Kontratën e Lizingut parashihet ndryshe.

KREU VI TË DREJTAT DHE DETYRIMET E FURNIZUESIT

Neni 24**Lizingmarrësi si përfitues i Kontratës së Furnizimit**

1. Në lidhje me marrëdhëniet e Lizingut Financiar, përfitimi nga detyrimet e furnizuesit dhënë lizingdhënësit sipas një Kontrate Furnizimi dhe të të gjitha garancive, të shprehura apo të nënkuptuara, përfshirë ato të cilësdo palë të tretë të ofruara në lidhje me ose si pjesë e kontratës së furnizimit, do të zgjerohet te lizingmarrësi siç është paraparë në Kontratën e Lizingut por në pajtim me kushtet e Kontratës së Furnizimit dhe të të gjitha garancioneve dhe pretendimeve që burojnë prej tyre.
2. Zgjerimi i përfitimit nga detyrimet e furnizuesit dhe të të gjitha garancive tek lizingmarrësi nuk:

- 2.1. ndryshon të drejtat dhe detyrimet e palëve në Kontratën e Furnizimit, të drejta dhe obligime të cilat burojnë prej saj ose jo; ose
 - 2.2. vendos ndonjë detyrë apo përgjegjësi mbi lizingmarrësin sipas Kontratës së Furnizimit.
3. Çfarëdo modifikimi apo anulimi i Kontratës së Furnizimit nga ana e furnizuesit dhe lizingdhënësit është e vlefshme edhe ndaj lizingmarrësit, përveç nëse përpara modifikimit ose anulimit furnizuesi është njoftuar se lizingmarrësi ka lidhur Kontratë lizingu që ka të bëjë me Kontratën e Furnizimit.
 4. Në rast se ndodh modifikimi ose anulimi ndërmjet furnizuesit dhe lizingmarrësit, lizingdhënësi përveç obligimeve të tij nga lizingmarrësi, konsiderohet të ketë pranuar si të qena zotimet të cilat furnizuesi i ka bërë lizingmarrësit si dhe garancitë e modifikuara apo të anuluarat të cilat kanë ekzistuar dhe kanë qenë në dispozicion të lizingmarrësit përpara modifikimit ose anulimit.
 5. Pavarësisht nga angazhimet dhe zotimet e furnizuesit dhënë lizingmarrësit sipas këtij neni, lizingdhënësi mban të gjitha të drejtat të cilat ai mund të ketë ndaj furnizuesit, të drejtat të cilat mund të burojnë nga një marrëveshje ndërmjet lizingmarrësit dhe furnizuesit ose nga ndonjë ligj tjetër.
 6. Palët nuk mund të heqin dorë nga dispozitat e këtij neni e as nuk mund të ndryshojnë efektin e tyre.

Neni 25

Ndryshimet tek Kontrata e Furnizimit

1. Kontrata e Furnizimit nuk plotësohet, ndryshohet midis lizingdhënësit dhe furnizuesit pa pëlqimin paraprak të lizingmarrësit. Nëse lizingmarrësi nuk e jep pëlqimin e tij për këtë ndryshim, lizingdhënësi konsiderohet se i ka pranuar detyrimet e furnizuesit ndaj lizingdhënësit.
2. Palët nuk mund të heqin dorë ose ndryshojnë efektin e dispozitave të këtij neni.

KREU VII FALIMENTIMI

Neni 26

Falimentimi i lizingdhënësit

1. Në rast të emërimit të një Administratori të falimentimit për pronën e lizingdhënësit, lizingmarrësi ka opsionin të paguajë pjesën e mbetur të kësteve të lizingut brenda periudhës së likuidimit sipas kushteve të pranuarat me të besuarin në falimentim dhe të fitoj të drejtën në Asetin objekt lizingu, nëse Kontrata e lizingut e parasheh bartjen e titullit tek lizingmarrësi.
2. Përveç nëse provohet që Kontrata e lizingut nuk është lidhur në kushte të arsyeshme nga pikëpamja komerciale, Kontrata e lizingut nuk mund të anulohet dhe mbetet në fuqi për çdo kreditor ose kreditorët e lizingdhënësit, të cilët përfitojnë titullin për Asetin objekt lizingu si rezultat i procedurës së falimentimit ose likuidimit.

Neni 27

Falimentimi i Lizingmarrësit

1. Në rast të emërimit të një Administratori të falimentimi për pronën e lizingmarrësit, Aseti objekt lizingu përjashtohet nga pasuria e falimentuar e lizingmarrësit, si dhe prej detyrimit ndaj kreditorëve të përgjithshëm dhe i rikthehet lizingdhënësit.
2. Në mënyrë të pavarur nga dispozita në paragrafin 1 të këtij neni, personi i besuar në falimentim mund të njoftojë lizingdhënësin, nëpërmjet postës së regjistruar, brenda tridhjetë (30) ditë pune nga data e lajmërimit të falimentimit, që lizingmarrësi dëshiron të vazhdojë me Kontratën e lizingut, rast në të cilin Kontrata e lizingut mbetet në fuqi, me kushtin që këstet e lizingut të jenë paguar në bazë të Kontratës së lizingut.
3. Në mënyrë të likuidimit të lizingmarrësit, i cili është një entitet juridik, pavarësisht nëse likuidimi është i detyrueshëm ose vullnetar, Aseti objekt lizingu mund të riposedohet nga lizingdhënësi, pa cenuar të drejtat e lizingmarrësit të parashtruara në Kontratën e lizingut.

LIGJI PËR LIZINGUN

KREU VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 28

1. Ligji mbi Detyrimet gjen zbatim në marrëdhëniet e lizingut tek të cilat ky ligj zbatohet vetëm në masën që nuk ka konflikt mes këtij ligji dhe Ligjit mbi Detyrimet. Në rast të ndonjë konflikti, do të zbatohet ky ligj.
2. Nëse dispozitat e Traktatit Ndërkombëtar ku Kosova është palë, ndryshojnë nga ato të këtij ligji, do të merren në konsideratë, dispozitat e Traktatit Ndërkombëtar.
3. Ky ligj është i zbatueshëm për kontratat ndërkombëtare të lizingut siç parashihet në nenin 5 nënparagrafi 3.2. i këtij ligji, nëse palët bien dakord që ky ligj të rregullon kontratën e lizingut.
4. Ky ligj shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në pajtim me të.

Neni 29

1. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë dhe Financave në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës do të nxjerrin akte nënligjore që specifikojnë mënyrën, afatin dhe kushtet e licencimit nën të cilat lizingdhënësit mund t'i ushtrojnë aktivitetet e lizingut Financiar dhe Operativ.
2. Lizingdhënësit duhet të aplikojnë në Bankën Qendrore të Kosovës për regjistrim dhe licencim për të fituar të drejtën e ofrimit të lizingut Financiar dhe Operativ. Lizingdhënësit duhet të marrin një aprovim me shkrim dhe licencën paraprakisht për të ushtruar aktivitetet e tyre të lizingut
3. Lizingdhënësit duhet të veprojnë në pajtim me të gjitha politikat, procedurat, dhe kushtet e licencimit dhe raportimit të përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës në lidhje me aktivitetet e lizingut.
4. Lizingdhënësit do të jenë pjesëmarrës në Regjistrin e Kredive të Bankës Qendrore të Kosovës dhe do të raportojnë çdo lizing Financiar dhe Operativ ashtu siç kërkohet nga Banka Qendrore e Kosovës.

5. Lizingdhënësi duhet të regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Kosovës (Regjistër) si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (ShPK) ose si Shoqëri Aksionare (ShA) në përputhje me Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe t'i plotësojë të gjitha kushtet përkatëse të parapara me atë Ligj.
6. Lizingdhënësi duhet të regjistrohet në Regjistër duke i cekur veprimtaritë e tyre afariste, dhe veçanërisht duke e përfshirë lizingun.
7. Lizingdhënësi duhet të veprojë në bazë të dispozitave të parapara me Rregulloren 1999/21 të amendamentuar me Rregullin XVI mbi Regjistrimin, Mbikëqyrjen, dhe Operimin e Institucioneve Financiare Jo-bankare të cilat veprojnë në Kosovë, të Autorizuara me Nenin 46 të Rregullores 1999/21. Lizingdhënësi duhet të regjistrohet si Institucion Financiar Jo-bankar sipas Rregullit XVI në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.
8. Në mënyrë që lizingdhënësit të ushtrojnë veprimtari lizingu, në regjistrimin e tyre në Bankën Qendrore të Kosovës duhet të përfshihet edhe autorizimi për t'u marrë me lizing ose ata duhet të kenë në posedim pëlqimin me shkrim të marrë paraprakisht nga Banka Qendrore e Kosovës.
9. Sipas Rregullit të amendamentuar XVI, Paragrafi 4.(a), Banka Qendrore e Kosovës është e vetmja që ka përgjegjësinë për regjistrimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të institucioneve financiare jo-bankare në Kosovë. Me qëllim të shmangies së ndonjë keqinterpretimi, kjo përfshinë veçanërisht institucionet të cilat merren me lizing.

Neni 30 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-103
25 qershor 2009**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-020-2009, datë
17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.**

Ligji Nr. 03/L-141**PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1
Fushëveprimi dhe qëllimi i ligjit**

1. Me këtë ligj themelohet Agjencia për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë si dhe përcaktohen detyrat e përgjegjësit e tij.

**Neni 2
Përkufizimet**

Në kuptimin e këtij ligji:

“**Agjencia**” do të thotë Agjenci për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar;

“**Konfiskimi**” do të thotë marrje e përhershme e sendit në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, apo organit tjetër kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi.

“**Ministria**” nënkupton Ministrinë e Drejtësisë;

“**Organ kompetent**” nënkupton çdo organ apo institucion që në të bazë të ligjit në fuqi është i autorizuar të bëjë sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë;

“**Pasuri të Sekuestruara ose të Konfiskuara**” konsiderohen sendet e luajtshme, sendet e paluajtshme, paratë dhe letrat me vlerë të cilat janë në qarkullim juridik;

“**Sekuestrim**” do të thotë marrja e përkohshme e sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi.

**KREU II
DISPOZITAT THEMELORE****Neni 3
Themelimi**

1. Me qëllim të administrimit profesional të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, Ministria themelon Agjencinë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar.
2. Struktura funksionale dhe organizative e Agjencisë rregullohet me akt të veçantë nënligjor të cilin e nxjerr Ministria.

**Neni 4
Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Agjencia:
 - 1.1. ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;
 - 1.2. ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës së organeve kompetente;
 - 1.3. mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent;
 - 1.4. angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar;

LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR

- 1.5. administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik;
- 1.6. raporton tek Ministri lidhur me punën e Agjencisë dy (2) herë në vit, por sipas kërkesës së Ministrisë edhe më shpesh.

Neni 5**Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar**

1. Agjencia bashkëpunon dhe ndihmon gjykatën, prokurorinë, apo organet tjera kompetente për ekzekutimin e vendimeve të tyre në lidhje me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.
2. Me kërkesë të prokurorisë apo gjykatës, Agjencia siguron mbështetje logjistike për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë.

Neni 6**Administrimi i të dhënave**

1. Agjencia mbledh, administron dhe procedon të dhënat, përfshirë vendimet e organeve kompetente dhe të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë.
2. Agjencia administron dhe ruan të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar dhjetë vite nga data kur Agjencia ka pranuar vendimin e formës së prerë për konfiskim nga gjykata apo organi tjetër kompetent.
3. Agjencia është i obliguar për ruajtjen e privatësisë së subjekteve të përfshirë në rastin konkret sipas ligjit në fuqi.
4. Të dhënat e organit kompetent përmbajnë informata të sakta në lidhje me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar dhe për personat ndaj të cilëve është shqiptuar masa e tillë.
5. Agjencia mund të kërkoj informata shtesë nga organet kompetente, të cilat i vlerëson si të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë së tij.

Neni 7**Administrimi i Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar**

1. Organi kompetent, i cili zhvillon procedurën për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë informon Agjencinë brenda dhjetë (10) ditësh lidhur me vendimin e nxjerrë.
2. Vendimi i gjykatës apo organit tjetër kompetent për sekuestrim ose konfiskim të pasurisë ekzekutohet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh dhe pasuria i dorëzohet Agjencisë.
3. Agjencia lëshon dëftesë për pranimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
4. Agjencia ndërmerr veprime të nevojshme për ruajtjen adekuate dhe sigurimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
5. Ruajtja e vlerës mund të sigurohet me mbajtjen apo shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar nga ana e Agjencisë, në mënyrë që të zëvendësohet me një kundërvlerë monetare.
6. Në rastet e veçanta Agjencia mund të kërkoj nga gjykata apo organi tjetër kompetent që pasuria e sekuestruar t'i lihet për ruajtje apo shfrytëzim personit të cilit i është sekuestruar sendi.
7. Përvetësimi apo shfrytëzimi i pa autorizuar i pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar është i dënueshëm me Kodin Penal të Kosovës.
8. Brenda dhjetë ditësh pas pranimi të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, Agjencia informon gjykatën apo organin tjetër kompetent i cili ka nxjerrë Vendimin për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, duke përfshirë një kopje të regjistrimit të pasurisë. Agjencia po ashtu informon gjykatën, apo organin kompetent për lokacionin, kushtet e përgjithshme, specifikat dhe vlerën e pasurisë.

Neni 8**Shitja e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar**

1. Me propozim të Agjencisë prokurori apo organi tjetër kompetent kërkon nga gjykata të vendos për

LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR

shitjen e një pasurie që është e zëvendësueshme dhe mund ta humbë vlerën në rast të magazinimit ose shpenzimet e magazinimit janë joproportionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar.

2. Gjykata njofton palët në procedurë dhe Agjencinë lidhur me vendimin për shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.
3. Pas pranimit të vendimit të gjykatës kompetente lidhur me shitjen e pasurisë, Agjencia zhvillon procedurën për shitjen e pasurisë në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 9**Procedura pas shitjes**

1. Pas shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar shuma e fituar e zëvendëson vlerën e pasurisë së shitur. Gjykata e cila ka marrë vendimin për shitje informohet nga Agjencia për rezultatin e shitjes.
2. Agjencia ka për obligim të administroj çdo shumë e cila fitohet nga shitja e pasurisë së konfiskuar.
3. Të hyrat e realizuara nga shitja deponohen në xhirrollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.
4. Kur gjykata apo organi tjetër kompetent vendos t'ia kthej pasurinë palës në procedurë, Agjencia është i detyruar që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të ekzekutoj vendimin.
5. Mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar, pas vendimit përfundimtar të gjykatës, derdhen në Buxhetin e Kosovës.

KREU III**Neni 10****Shkëmbimi i informatave**

1. Çdo person fizik apo juridik, të cilit i është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, ka të drejtë të kërkojë dhe të informohet nga agjencia për pasurinë e tij të sekuestruar ose të konfiskuar.

2. Personat e tretë fizikë apo juridikë, të cilët kanë interes juridik mund të kërkojnë informacione të nevojshme nga Agjencia lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.

Neni 11

Secili zyrtar i Agjencisë është i detyruar që t'i ruaj fshehtësitë për të gjitha të dhënat të cilat konsiderohen konfidenciale. Informatat e caktuara mund të zbulohen vetëm në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

KREU IV**Neni 12****Dispozitat kalimtare**

1. Ky ligj zbatohet edhe në rastet për të cilat procedura gjyqësore për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë është në zhvillim e sipër në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Brenda gjashtë muajve, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria duhet të nxjerrë akte nënligjore që burojnë prej tij.

Neni 13**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2010.

**Ligji Nr. 03/ L-141
10 korrik 2009**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-021-2009, datë
17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.**

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ligji Nr. 03/L-136

PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË
DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË
HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke pasur parasysh dispozitat e nenit 41 të Ligjit për të huajt;

Me qëllim të vendosjes dhe aplikimit të dispozitave ligjore për dhënie e lejeve për punë dhe punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR DHËNIEN E LEJES PËR
PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE
TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËSNeni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat e dhënies së lejes së punësimit për shtetasit e huaj në Republikën e Kosovës, sipas kushteve të përcaktuara me ligj, konventave ndërkombëtare të punës dhe marrëveshjeve ndërshtetërore.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Me këtë ligj vendosen rregullat për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Në zbatim të këtij ligji termat vijuese kanë këto kuptime:

“I huaj” është çdo person, i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës.

“Leje pune” është dokumenti zyrtar i dhënë një të huaji nga organi kompetent, për qëllime biznesi, për t’u punësuar ose për t’u vetëpunësuar.

“Emigrim” është lëvizja e një personi apo grupi personash nga territori i Republikës së Kosovës në një vend tjetër, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë daljen nga vendi i origjinës, udhëtimin, transitin, hyrjen dhe qëndrimin në vendin e pritës.

“Imigrimi” është lëvizja e një personi apo grupi personash, të cilët hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës nga një vend tjetër, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore.

“Leje qëndrimi” është dokumenti që i jepet të huajit për të qëndruar në territorin e Republikës së Kosovës.

“Azil” - është mbrojtja që Kosova i ofron refugjatëve. Azili përfshin të drejtën për vendqëndrim në Republikën e Kosovës si dhe të drejtat e tjera që parashihen me ligj.

“Puna Sezonalë” është marrëdhënie e punës në kohë të caktuar e cila mund të zgjatë tre (3) deri nëntë (9) muaj.

Neni 4

Politikat për dhënie e lejes së punës për shtetasit e huaj

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me politikën e migracionit, gjendjes dhe lëvizjes në tregun e punës, në fund të çdo viti cakton numrin e lejeve të punës për vitin e ardhshëm, për shtetasit e huaj, në përputhje me nevojat dhe mundësitë e punësimit të të huajve në vendin tonë.
2. Numrin e lejeve për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës e propozon Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Numri i lejeve të punës për punësimin e shtetasve të huaj caktohet më së largu, deri më 15 dhjetor të vitit aktual, për vitin e ardhshëm.

Neni 5
Leja e Punës

1. Personat fizikë, që nuk janë shtetas të Kosovës, kur dëshirojnë të punojnë në territorin e Republikës së Kosovës për një afat kohor prej se paku tre (3)

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

muaj, duhet të pajisen me leje pune të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale.

2. Personi juridik nëse i plotëson kushtet dhe kriteret sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera në Republikën e Kosovës duhet të pajiset me leje pune nga Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale.

Neni 6**Llojet e lejeve të punës**

1. Llojet e lejeve të punës mund të jenë:
 - 1.1. leje pune e tipit A i jepet të huajve për një kohë jo më shumë se gjashtë (6) muaj;
 - 1.2. leje pune e tipit B i jepet të huajve për t'u punësuar në një profesion të caktuar në një zonë gjeografike të caktuar të një punëdhënës të caktuar;
 - 1.3. leja e punës e tipit B jepet për një periudhë një (1) vjeçare;
 - 1.4. ky tip leje pune mund të ripërtërihet për një afat kohor njëvjeçar, kur nuk kanë ndryshuar rrethanat kryesore të dhënies së lejes së punës së mëparshme;
 - 1.5. leje pune e tipit C i jepet të huajve rezidentë në Republikën e Kosovës, që kanë marrë leje pune të tipit B, vlefshmëria totale e të cilave kap afatin kohor minimal tre (3) vjeçar, gjatë një periudhe të vazhdueshme banimi. Leje pune e tipit C iu jepet të huajve për t'u punësuar në çdo veprimtari dhe në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pa kufizime në punëdhënës të caktuar. Ky tip leje pune jepet për një afat kohor pesë (5) vjeçar;
 - 1.6. leje pune e tipi D (leje vetëpunësimi) u jepet personave të huaj të vetëpunësuar, duke kufizuar veprimtarinë e tyre në një zonë gjeografike të caktuar. Kohëzgjatja e kësaj leje pune është një vit (1) me të drejtë ripërtëritjeje;
 - 1.7. leje pune e tipit E (leje vetëpunësimi) u jepet personave të huaj të vetëpunësuar për çdo lloj veprimtarie dhe pa kufizime gjeografike, të cilat kanë marrë leje pune të njëpasnjëshme të tipit, vlefshmëria e të cilave ka afatin minimal tre (3) vjet. Kjo leje pune është

e vlefshme me afat kohor deri në pese (5) vjet;

- 1.8. leje pune e tipit F (për studentë) u jepet personave të huaj që studiojnë në Kosovë për vitin mësimor në vazhdim. Kjo leje pune jepet vetëm për orare pune të reduktuara gjatë vitit mësimor dhe me orar të plota pune gjatë pushimeve midis viteve akademike apo semestrave;
- 1.9. leje pune e tipit G u jepet të huajve që investojnë në Republikën e Kosovës dhe punësojnë jo më pak se dy (2) shtetas kosovarë për çdo shtetas të huaj të punësuar. Afati i kësaj lejeje është një vit (1) me të drejtë ripërtëritjeje;
- 1.10. leje pune e tipit H u jepet të huajve të cilët kanë pasur më parë leje të njëpasnjëshme të tipit G, vlefshmëria e të cilave kap afatin kohor minimal tre (3) vjet. Leja e punës e tipit H jepet për një afat kohor pesë (5) vjeçar.

Neni 7**Mënyra e paraqitjes së kërkesës për leje pune**

1. Kërkesa për pajisje me leje pune bëhet me shkrim përpara fillimit të punës, duke plotësuar formularët zyrtarë përkatës.
2. Formularët për kërkesë merren në Zyrat e Punësimi të cilat veprojnë dhe punojnë në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 8**Organet kompetente për dhënien e lejes së punës**

1. Lejen e punës për Shtetasin e huaj dhe pa shtetësi e lëshon, Departamenti i Punës dhe Punësimi në Kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Leja e punës e cila është lëshuar për një punëdhënës, nuk mund të bartet te punëdhënësi tjetër.
3. Leja e punës nuk mund t'iu lëshohet personave të cilët qëndrojnë në Kosovë sipas lejes (vizës) turistike.

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**Neni 9****Vazhdimi i lejes së punës**

1. Kërkesa për vazhdimin e lejes së punës, përveç lejes së punës sezonale, bëhet një muaj para mbarimit të afatit të lejes ekzistuese.
2. Kërkesa vazhdohet brenda një muaji, nëse rrethanat kryesore të dhënies së mëparshme të lejes së punës nuk kanë ndryshuar.
3. Për kërkesën e vazhimit të lejes së punës dhe vazhdimin e qëndrimit të përkohshëm, vendimi merret në të njëjtën kohë.

Neni 10**Dokumenti zëvendësues i lejes së punës**

1. Në rastet kur leja e punës humbet ose dëmtohet, zëvendësohet me një leje pune të re.
2. Për periudhën gjatë së cilës kryhet procedura e ripërtëritjes së lejes së punës, të huajit do ti jepet një leje pune e përkohshme, me vlefshmëri nga koha e dorëzimit të lejes së vjetër deri në pajisjen e të huajit me leje pune të re.
3. Në rast të humbjes së lejes së punës, shtetasi i huaj është i detyruar ta shpallë të pavlefshme në shtypin ditor të Kosovës.

Neni 11**Shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes së punës**

1. Dhënia e lejes së punës për një shtetas të huaj do të refuzohet, nëse:
 - 1.1. gjendja e tregut kosovar të punës nuk e lejon këtë punësim të rregulluar me akt nënligjor;
 - 1.2. marrëdhëniet dhe kushtet e shprehura në kontratë nuk përmbushin kërkesat e legjislacionit kosovar si dhe të konventave ndërkombëtare;
 - 1.3. informacioni dhe dokumentet e kërkuara lihen qëllimisht të paplotësuara apo janë të pasakta;
 - 1.4. punëmarrësi i huaj nuk paraqet kërkesën brenda afatit të përcaktuar për ripërtëritjen e lejes së punës;

- 1.5. ka arsye të rëndësishme që përbëjnë rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.

Neni 12**Ndërprerja e lejes së punës**

1. Leja e punës ndërpritet kur:
 - 1.1. skadon afati kohor për të cilën ajo është lëshuar;
 - 1.2. i huaji largohet nga Republika e Kosovës për një periudhë mbi gjashtë (6) muaj;
 - 1.3. ndërkrehet leja e qëndrimit në Republikën e Kosovës;
 - 1.4. sjelljet e të huajve janë në kundërshtim me legjislacionin e Kosovës.

Neni 13**Përfashtimet nga detyrimet për pajisje me leje pune**

1. Përfashtohen nga pajisja me leje pune, kategoritë e mëposhtme të të huajve:
 - 1.1. përfaqësuesit e përfaqësive diplomatike të organizatave ndërkombëtare me status diplomatik, si dhe të huaj që janë punonjës të këtyre përfaqësive;
 - 1.2. personeli kyç i ndërmarrjeve tregtare i cili është definuar me marrëveshjen për stabilizim-asocimin në mes shteteve anëtare të BE-së dhe Kosovës;
 - 1.3. përfaqësuesit e organizatave joqeveritare pa qëllime fitimi;
 - 1.4. drejtorë ekzekutivë të kompanive të huaja që kanë veprimtari apo që kanë qëllim të hapin veprimtari në Republikën e Kosovës;
 - 1.5. profesionistë të një kompanie të huaj, që vijin për të punuar në degët apo filialet e kësaj kompanie në Republikën e Kosovës;
 - 1.6. specialistë të ardhur në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe;
 - 1.7. personeli i transportit ndërkufitar i mallrave dhe njerëzve;
 - 1.8. lektorë, pjesëtarë të stafëve shkencore, pedagogë të universiteteve, pjesëtarë të stafëve shkencore të organizatave shkencore private, nëse ka interes publik, si shkak i njohurive të tyre të veçanta;

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

- 1.9. përfaqësues të mas-medias, korrespondentë ose reporterë, që punojnë për një punëdhënës të huaj;
- 1.10. studentë të universiteteve që marrin pjesë në një shkëmbim të punëve gjatë pushimeve veriore, si rezultat i marrëveshjeve përkatëse.
- 1.11. zyrtarët ushtarak dhe civil të qeverive të shteteve tjera, të cilët në Kosovë vijnë për të punuar në bazë të kontratës për bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës;
- 1.12. përfaqësuesit e bashkësive fetare të cilët kryejnë veçanërisht punët që lidhen me shërbimin fetarë.

Neni 14**Anulimi i lejes së punës**

1. Leja e punës anulohet nga organi kompetent nëse:
 - 1.1. është lëshuar në bazë të të dhënave të pavërtetuara për punëtorin apo punëdhënësin;
 - 1.2. punëdhënësi nuk e lidh kontratën me të huajin në afatin e paraparë ligjor;
 - 1.3. i huaji në bazë të lejes së punës, kryen punët për të cilat nuk është lidhur kontrata e punës;
 - 1.4. punon për punëdhënësin tjetër me të cilin në bazë të lejes së punës nuk ka mundur të lidhë kontratë pune;
 - 1.5. të huajit nuk iu është lejuar apo iu është ndërprerë qëndrimi i përkohshëm në Republikën e Kosovës.

Neni 15**Kushtet e veçanta për punësimin e shtetasit të huaj**

1. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjeve të tjera në fuqi, shtetasi i huaj për t'u punësuar në Republikën e Kosovës, duhet të përmbushë edhe këtë kusht:
 - 1.1. të ketë lejen e qëndrimit në Republikën e Kosovës, sipas Ligjit për të Huaj;

Neni 16**Dokumentacioni i nevojshëm**

1. Me kërkesën për lejen e punës, punëdhënësi është i obliguar të dorëzojë:

- 1.1. Dokumentin për lejen e qëndrimit në Republikën e Kosovës, apo vërtetimin për posedimin e vizës së vlefshëm zyrtare;
- 1.2. Të dhënat për vendin e punës, kualifikimin dhe llojin e punës për punësimin e shtetasit të huaj;
- 1.3. Të dhënat për selinë e punëdhënësit, me arsyetimin për nevojën e punës për shtetasin e huaj, kushtet e lidhjes së kontratës së punës, për numrin e të punësuarve, llojet e punës dhe kohëzgjatjen e tyre;
- 1.4. Certifikatën për regjistrim të biznesit apo veprimtari të ngjashme ose profesion të lirë, udhëheqë punët në ndërmarrjen e tij tregtare, ka shumicën e aksioneve në ndonjë shoqëri aksionare në Kosovë apo të huajit të cilit i ofron shërbime në emër të punëdhënësit të huaj.
- 1.5. Vërtetimin nga Zyra e Punësimit, përmes të cilit vërtetohet se në mesin e punëkërkesve kosovarë nuk ka të atillë të cilët i plotësojnë kushtet e punësimit ku do të punojë shtetasi i huaj

Neni 17**Kontrata e Punës**

1. Lidhja e kontratës për themelimin e marrëdhënies së punës për shtetasin e huaj bëhet në pajtueshmëri me legjislacionin nga fusha e punës dhe punësimit.

Neni 18**Afati i lëshimit të kontratës**

Punëdhënësi, është i obliguar ta lidhë kontratën e punës me shtetasin e huaj, në formë të shkruar para fillimit të punës, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e lëshimit të lejes së punës.

Neni 19**Barazia para ligjit**

Personi juridik dhe fizik ka përgjegjësi dhe obligime të barabarta në punë si shtetasi i Republikës së Kosovës, përveç nëse me marrëveshje ndërshtetërore apo konventa ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe.

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**Neni 20****Afati për dhënien ose refuzimin e lejes së punës**

Afati për dhënien ose refuzimin e kërkesës për lejen e punës është jo më shumë se tridhjetë (30) ditë nga data e paraqitjes së dokumentacionit pranë organit kompetent.

Neni 21**Ankimi**

1. Në rast refuzimi të kërkesës për lejen e punës, shtetasi i huaj njoftohet me shkrim.
2. Shtetasi i huaj apo personi tjetër i interesuar në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e njoftimit për refuzimin e kërkesës për lejen e punës, ka të drejtë ankese në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
3. Organi përgjegjës i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me ankesën e paraqitur nga shtetasi huaj, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh lëshon vendim, nga dita e paraqitjes së ankesës.
4. Kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesës për dhënien e lejes së punës për shkak të plotësimit të numrit të lejeve të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës, nuk lejohet ankesa.
5. Kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për dhënien e lejes së punës nga paragrafi 1. i këtij neni, shtetasi i huaj, mund të iniciojë konflikt administrativ.

Neni 22**Dispozitat Ndëshkimore**

1. Punëdhënësi me cilësi të personit juridik do të ndëshkohet për kundërvajtje, dënime me të holla prej njëmijepesëqind (1.500) deri në tremijë (3000) Euro, nëse:
 - 1.1. e punëson shtetasin e huaj pa lejen e Punës;
 - 1.2. shtetasi i huaj sistemohet në punë tjetër në kundërshtim me lejen e punës dhe kontratën e punës;

- 1.3. leja e punës bartet te ndonjë punëdhënësi tjetër;
- 1.4. shtetasit të huaj i vazhdohet kontrata e punës, pas përfundimit të lejes së punës.

2. Shtetasi i huaj me cilësi të personit fizik do të ndëshkohet për kundërvajtje, me dënime me të holla prej pesëqind (500) deri njëmijë (1000) Euro, nëse:

- 2.1. gjatë kryerjes së punës i shkelë rregullat dhe dispozitat nga fusha e punës dhe sigurimit social;
- 2.2. vazhdon të punojë edhe pas skadimit të afatit të lejes së punës;
- 2.3. kryen veprimtari pa leje pune;
- 2.4. ushtron veprimtari në kundërshtim me lejen e punës për të cilën i është lëshuar.

Neni 23**Mbikëqyrja**

Mbikëqyrjen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera pozitive përkatëse e bën Inspektorati i Punës, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 24**Hartimi i akteve nënligjore në pajtim me Ligjin**

Punëdhënësit kanë për detyrë që aktet nënligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës për shtetasit e huaj t'i harmonizojnë me dispozitat e ligjit, më së largu brenda gjashtë (6) muajsh, pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Neni 25**Organi kompetent për lëshimin e lejes së punës**

1. Organ kompetent për lëshimin e lejes së punës është Departamenti i Punës dhe Punësimit i cili vepron dhe punon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Departamenti i Punës dhe Punësimit është i obliguar që për lëshimin dhe ndërprerjen e lejes së punës, të informojë Ministrinë e Punëve të Brendshme në

LIGJI PËR DHËNIEN E LEJES PËR PUNË DHE PUNËSIMIN E SHTETASVE TË HUAJ NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

afatin prej tri (3) ditësh nga dita e lëshimit, përkatësisht ndërprerjes së lejes së punës.

3. Ministria e Punëve të Brendshme, në bazë të vendimit për ndërprerjen e lejes së qëndrimit të përhershëm apo të përkohshëm, në rastet kur shtetasi i huaj është i punësuar, sipas detyrës zyrtare, e informon Departamentin e Punës dhe Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 26
Zbatimi i Ligjit

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në afatit prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, në koordinim me ministritë përkatëse, nxjerr akte nënligjore, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-136
10 korrik 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-022-2009, datë
17.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.

Ligji Nr. 03/L-158

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/17 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 02/ L-99

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/17 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 02/ L-99

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave të procedurës së prokurimit publik për nevojat e misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës

Neni 2

Neni 4 i LPP-së të përkufizimi i zyrtarit kryesor administrativ(ZKA), në fund të tekstit, pas fjalës "personelit."shtohet teksti si vijon:

Në rastin e misionit diplomatik/konsullor si dhe përfaqësuesit të autorizuar nga shefi i misionit, ZKA nënkupton shefin e këtij misioni ose të autorizuarin e tij.

Neni 3

Nenit 24 të LPP i shtohet paragrafi i ri 24.5 me tekstin si vijon:

24.5. Nënshkrimi i kontratave për vlera minimale dhe të vogla, në aktivitetet e prokurimit të misioneve diplomatike dhe konsullore, bëhet nga shefi i misionit diplomatik apo konsullor ose i autorizuari i tij. Shefi

i Misionit diplomatik/konsullor është përgjegjës për shpenzimet e buxhetit brenda misionit diplomatik/konsullor.

Neni 4

Nenit 30A të LPP-së i shtohet paragrafi i ri 30A 7. me tekstin si vijon:

30.A.7. Të gjitha aktivitetet e prokurimit të vlerave të mesme dhe të mëdha për misionet diplomatike dhe konsullore zhvillohen nga Ministria e Punëve të Jashtme në pajtim me procedurat e përcaktuara në LPP-së.

Neni 5

Nenit 34 të LPP-së i shtohen paragrafët e rinj me tekstin si vijon:

- 34.10. Kërkesat e përcaktuara me nenin 34.1 të LPP-së nuk aplikohen për misionet diplomatike dhe konsullore.
- 34.11. Shefi i Misionit diplomatik/ konsullor pasi që identifikon pronën e përshtatshme të mundshme, udhëheq negociatat për ofertën dhe kushtet, për marrje me qira të objekteve.
- 34.12. Për marrjen me qira të objekteve për zyra si dhe për objekte banimi së pari duhet t'i paraprijë një kërkesë me shkrim nga ana e Shefit të misionit Diplomatik/konsullor drejtuar zyrtarit aprovues të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ-së), ku ky i fundit duhet të shqyrtojë dhe të bëjë aprovimin e kërkesës së bërë nga ana e shefit të misionit.
- 34.13. Shefi i misionit diplomatik/ konsullor mund të angazhojë një kompani vendore në shtetin pranues, për ndërmjetësim të marrjes së objektit me qira të misioneve diplomatike apo konsullore.
- 34.14. Të gjitha marrëveshjet për hapësirat e marra me qira për zyra të misioneve diplomatike apo konsullore bëhen në emër të misionit diplomatik dhe konsullor.
- 34.15. Misioni diplomatik dhe konsullor mund të lidhë kontratë në kohëzgjatje deri në pesë (5) vite.
- 34.16. Mund të lejohet avansi në maksimum deri në dymbëdhjetë (12) muaj, ku përfshihen page-

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 2003/17 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 02/ L-99

sat e kaucioneve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes së objekteve të zyrave dhe të banimit.

- 34.17. Shefi i misionit diplomatik/ konsullor i dërgon MPJ-së kërkesën për blerjen e automjetit me më shumë se një ofertë. Në raste të tilla MPJ themelon komision të brendshëm prej tre anëtarësh, i cili bën vlerësimin e kërkesës dhe jep aprovimin apo refuzimin për fillimin e negociatave nga ana e shefit të misionit diplomatik dhe konsullor
- 34.18. Pas aprovimit të kërkesës nga ana e Komisionit të MPJ-së, shefi i misionit diplomatik/ konsullor fillon negociatat me operatorin ekonomik mbi bazën e parimeve të transparencës jo diskriminimit dhe ekonomicitetit.
- 34.19. Për blerjen e objekteve për misionet diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës përdoren procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës.
- 34.20. Për blerjen e Objekteve për misionet diplomatike/konsullore paraprakisht merret vendim nga Qeveria.
- 34.21. Pas Vendimit të Qeverisë, Qeveria cakton një Komision profesional për zhvillimin e negociatave me subjektin që e shet pronën (objektin).
- 34.22. Përbërja, kompetencat dhe funksionimi i Komisionit profesional rregullohet me akt nënligjor të Qeverisë.
- 34.23. Pasuria e luajtshme dhe e paluajtshme e Misioneve diplomatike dhe konsullore janë pasuri e Republikës së Kosovës.
- 34.24. Ministria e Punëve të Jashtme mban evidencën e të gjithë pasurisë së luajtshme dhe paluajtshme të misioneve diplomatike/konsullore.

Neni 6

Nenit 35 të LPP-së i shtohen paragrafët e rinj me tekstin si vijon:

- 35.11. Për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit për misionet diplomatike/ konsullore, të cilat nuk tejkalojnë vlerën njëmijë (1.000) Euro, bëhet përjashtimi i procedurave të prokurimit të përcaktuara në nenin 36 të LPP-së.

- 35.12. Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore zhvillojnë procedurat e kuotimit të çmimit për furnizime dhe shërbime për nevojat e veta.
- 35.13. KRRP-ja përcakton procedurë të veçantë për kuotimin e çmimit për misionet diplomatike/ konsullore dhe harton legjislacionin sekondar për këtë procedurë brenda tridhjetë (30) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
- 35.14. Ministria e Punëve të Jashtme mbikëqyr kryerjen dhe përfundimin e këtyre procedurave.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-158
24 korrik 2009

Shpallur me dekretin Nr. DL-023-2009, datë
31.07.2009 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
Dr. Fatmir Sejdiu.

